




**ANALIZA
E CILËSISË DHE
BARAZIMIT TË VENDIMEVE
GJYQËSORE NË FUSHËN
CIVILE-JURIDIKE**



**ANALIZA
E CILËSISË DHE
BARAZIMIT TË
VENDIMEVE GJYQËSORE
NË FUSHËN CIVILE-JURIDIKE**

ANALIZA E CILËSISË DHE BARAZIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE-JURIDIKE

Titulli origjinal i publikimit:
АНАЛИЗА НА КВАЛИТЕТ И ВОЕДНАЧЕНОСТ НА
СУДСКИТЕ ОДЛУКИ ВО ГРАЃАНСКО-ПРАВНАТА ОБЛАСТ

Botues:
Instituti për politikë evropiane - Shkup
Asociacioni për iniciativa zhvillimore - Zenit Shkup

Redaktor:
Prof. Dr. Jovan Ananiev

Autor:
Dushko Georgievski

Lektor:
Dejan Vasilevski

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe:
Orhan Kadrievski

Disenji dhe shtypi:
Relativ

Shkup, Korrik 2021

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
347.95:347(497.7)"2017/2020"(047.31)

GEORGIEVSKI, Dushko

Analiza e cilësisë dhe barazimit të vendimeve gjyqësore në fushën civile-juridike [Електронски извор] / [autor Dushko Georgievski ; përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe Orhan Kadrievski]. - Shkup : Instituti për politikë evropiane : Zenit, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://epi.org.mk/post/17482?lang=sq>. - Превод на делото: Анализа на квалитет и воедначеност на судските одлуки во граѓанско-правната област. - Текст во PDF формат, содржи 66 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 12.09.2021. - Содржи и: Aneksi

ISBN 978-608-4702-06-1 (Институт за европска политика)

ISBN 978-608-4758-13-6 (Zenit)

a) Судски одлуки -- Граѓанско право -- Македонија -- 2017-2020 -- Истражувања
COBISS.MK-ID 54820613



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Partneriteti Justicija – kthimi i besimit të qytetarëve", i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve në Ministrinë e Financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	6
HYRJE	7
QËLLIME DHE METODOLOGJIA	9
1. ANALIZA E KUALITETIT TË VENDIMEVE GYQËSORE NË SFERËN E TË DREJTËS CIVILE	13
1.1 MOSTËR PËR ANALIZË	15
1.2 ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GYQËSORE TË RAJONEVE TË APELIT	16
1.3 KUALITETI I VENDIMEVE GYQËSORE NË NIVEL KOMBËTAR	26
2. ANALIZA E KUALITETIT NË ASPEKT TË BARAZIMIT TË VENDIMEVE GYQËSORE NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE	29
2.1 KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS	32
2.2 ANALIZA E KUALITETIT TË VENDIMEVE NGA ASPEKTI I BARAZIMIT TË VENDIMEVE GYQËSORE NË NIVELIN E RAJONEVE TË APELIT	33
2.3 BARAZIA E VENDIMEVE NË NIVEL KOMBËTAR	55
KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET	57
ANEKSI	61



PARATHËNIE

Kjo analizë është bërë brenda projektit "Partneriteti Justicia: Kthimi i besimit të qytetarëve", që e zbatojnë Instituti për politikë evropiane dhe Asociacioni ZENIT, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti synon të kontribuojë për kthimin e besimit të qytetarëve në sektorin e drejtësisë maqedonase përmes përfshirjes së rëndësishme të shoqërisë civile në reformat thelbësore. Përfituesit përfundimtarë të këtij projekti janë institucionet në fushën e drejtësisë. Qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës për kundërvajtje, të vetë procedurës me qëllim që t'iu përgjigjet pritjeve të qytetarëve në lidhje me të drejtën për një gjykim fer dhe të drejtë si dhe për qasje në drejtësi.



HYRJE

Qëllimi i kësaj analize është vlerësimi i cilësisë së vendimeve të të gjitha fushave të apelit në RMV sipas metodologjisë së dhënë, dhe gjithashtu të bëhet analizë e barazimit të tyre, përkatësisht sa nga vendimet e zgjedhura rastësisht për të cilat ekziston tashmë praktikë e vendosur gjyqësore (mendime juridike parimore, sentenca ose konkluzione të Gjykatës Supreme të RMV-së ose lëndë për të cilat ka sjellë vendime nga GJEDNJ), janë barazuar me praktikën e tillë gjyqësore. Gjithashtu, këto dy kriteret e analizës duhet të tregojnë vazhdimisht cilësinë dhe barazimin e vendimeve për secilën fushë të apelit veçmas, dhe nga ajo të nxjerrin të dhëna për cilësinë dhe barazimin e vendimeve në nivel kombëtar. Mostrat për analizë janë vendime të miratuara vitit 2017, 2018, 2019 dhe 2020 në të cilat njëra palë është person fizik.

Në bazë të analizave të bëra përmes treguesve kuantitativë dhe kualitativë dhe analizave të barazimit të vendimeve gjyqësore, janë përcaktuar cilësia e vendimeve gjyqësore për çdo rajon të apelit dhe barazia e vendimeve të miratuara në çdo rajon të apelit, dhe në fund të këtij raporti është bërë sipas këtyre kriterëve edhe në nivel kombëtar, dhe sipas gjendjeve aktuale janë dhënë rekomandime në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe Supreme të RMV-së, si dhe në Këshillin Gjyqësor të RMV-së, në aspekt të gjendjeve të konstatuara për rritjen cilësisë së vendimeve, e që duhet të miratohen në të ardhmen, si dhe barazimit të tyre.



QËLLIME DHE METODOLOGJIA

Analiza është përgatitur, në bazë të vendimeve të analizuara të gjyqësore, të gjykatave themelore dhe të apelit, diku dhe në numër më të madh se sa që është rekomanduar me metodologjinë, me përjashtim të analizës së barazimit për shkak të mungesës së vendimeve të përshtatshme për të cilat është vendosur praktikë gjyqësore.

Të gjitha vendimet, pavarësisht nga qasja ose kriteri i analizës, janë analizuar veçmas, përkatësisht janë analizuar veçmas, pa u krahasuar me vendim tjetër, vendime tjera gjyqësore nga një gjykatë në të njëjtin nivel ose gjykata të nivelit më të lartë.

Qëllimi kryesor i analizës është përmes treguesve kuantitativë të bëhet vlerësim cilësor i vendimeve të miratuara marra në periudhën e caktuar në nivelin e katër rajoneve të apelit dhe në nivel kombëtar dhe përmes një analize të tillë të përcaktohet nëse sipas këtij kriteri ka ndonjë dobësi që janë karakteristike për rajon të caktuar të apelit. Ndërsa, në pjesën e barazimit të vendimeve gjyqësore të konstatohet nëse i kushtohet vëmendje ekuilibrit midis barazisë së njerëzve para ligjit dhe sigurisë juridike, nga njëra anë dhe mungesës së ashpërsisë, zhvillimit dhe pavarësisë gjyqësore, nga ana tjetër. Barazimi i vendimeve gjyqësore është i rëndësishëm sepse siguron sundimin e të drejtës, i cili bazohet, ndër të tjera, në sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë. Qytetarët dhe personat juridikë kanë të drejtë të dinë se si gjykohet në raste të ngjashme, dhe kështu të kenë siguri juridike në vend. Praktika gjyqësore u mundëson gjykatave të punojnë në mënyrë më efektive, ndërsa palëve dhe avokatëve u jep mundësi të dinë nëse fillimi i një procesi gjyqësor mund të çojë në mënyrën e dëshiruar dhe të mundshme të zgjidhjes së një kontesti të tillë.

Analiza e kualitetit të vendimeve gjyqësore kryhet në bazë të më shumë treguesve: struktura dhe koherenca, logjika juridike, cilësia e arsytimit - shpjegimi i historisë së çështjes, prezantimi i çështjes, prezantimi dhe zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse dhe parimet juridike, gjendja faktike dhe procedura e provave, shqyrtimi dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta, qartësia dhe konsistenca e arsytimit, korrektesia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor. Ndërsa, në vendimet e Gjykatave të Apelit, treguesit përcaktohen sipas asaj nëse ka udhëzime të qarta për gjykatën themelore gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim, nëse janë cekur qartë arsyet e anulimitose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Pastaj, i jepet përgjigje ankesave, nuk përcaktohet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit ka të gjitha karakteristikat në përcaktimin e gjendjes faktike, duke analizuar provat, duke theksuar të drejtën materiale dhe arsytimin, si dhe për çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë, vendimet e gjykatës së apelit, të cilat refuzojnë ankesën, ka arsytim vetëm për ato ankesa, të cilat nuk janë cekur më parë dhe për të cilat ka nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjatë përzgjedhjes së vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore dhe të apelit, kriteri i rëndësishëm është që vendimet t'u referohen çështjeve juridike, për të cilat ekziston

praktika gjyqësore maqedonase, përkatësisht në lidhje me to, Gjykata Supreme ka miratuar qëndrime të përgjithshme juridike, mendime të përgjithshme juridike, mendime dhe konkluzione juridike dhe vendimet ose konkluzionet në mbledhje të gjykatave të apelit. Me rëndësi të veçantë është fakti se nuk është kriter përzgjedhës nëse është cituar praktika gjyqësore në vendimet gjyqësore, por nëse çështjet juridike janë përfshirë në praktikën gjyqësore.

Analizat janë kryer me ndihmën e formularëve - tabelave në eksel, me ç'rast mënyra e vlerësimit të kualitetit dhe kuantitetit të vendimeve kryhet si më poshtë:

- në lidhje me analizën për vlerësimin e kualitetit të vendimeve të gjykatave themelore, është përdorur formulari 1A, ndërsa për analizën e vendimeve të gjykatave të apelit - formulari 1B;
- në këto formulare, në kolonën e parë janë cekur treguesit që do të vlerësohen në aspektin kuantitativ;
- në kolonën e dytë jepen vlerësimet e vendimit të gjykatës në bazë të treguesit të caktuar;
- parimi i analizës së dy formulareve është pothuajse identik;
- nëse ndonjë tregues nuk është i rëndësishëm për vendimin gjyqësor, në atë fushë lihet vend bosh, e gjatë vlerësimit kuantitativ ato vende bosh nuk merren parasysh, por vetëm ato që vlerësohen me rezultatin nga -1 deri në 3, përfshirë 0;
- për treguesit që nuk mund të njihen në një vendim të caktuar gjykatë, vendoset një vlerë -1, nëse ka, dhe nuk i plotëson kriteret minimale të cilësisë, merr 0, nëse ka një cilësi minimale, nota është 1, për cilësinë e mesme vlerësohet me 2, dhe për cilësinë më të lartë të një treguesi të caktuar rezultati më i lartë është 3.
- në kolonën me numrin rendor 3 janë renditur koeficientët që varen nga kompleksiteti dhe rëndësia e secilit tregues, me ç'rast në këtë mënyrë kryhet peshimi i secilit kriter individual; (për shembull, nuk mund të ketë kuptimin e njëjtë një gabim gjuhësor me logjikën juridike të ndonjë vendimi gjyqësor ose thirrje në praktikën gjyqësore evropiane gjatë analizës së barazimit vendimit gjyqësor.
- për analizën kuantitative të barazisë së vendimeve gjyqësore, treguesi i parë I1 është eliminues, që do të thotë se nëse nuk ka thirrje në praktikën gjyqësore maqedonase ose praktikën e GJEDNJ -së, shfrytëzohen treguesit që kanë të bëjnë me këtë pjesë, e nëse në vendimin gjyqësor është zbatuar praktika gjyqësore dhe vendore edhe nga GJEDNJ, atëherë vlerësohen të gjithë treguesit, sipas vlerësimeve sipas parimit të njëjtë për kualitetin e vendimeve, që është sqaruar më lart.

- Në bashkëngjitje të këtij raporti gjenden tabelat, formulari 1A i shfrytëzuar për analizën e vendimeve të gjykatave themelore, Formulari 1B i cili është shfrytëzuar për analizën e vendimeve të gjykatave të apelit dhe formulari - Shtojca 2, për analizën e barazimit të vendimeve . Në fund, indeksi i kualitetit të vendimit gjyqësor fitohet si herës nga mbledhja e vlerave të treguesve me numrin e treguesve të analizuar, përkatësisht të vlerësuar. Në këtë mënyrë është arritur deri te mesatarja e cilësisë së vendimeve të gjykatave themelore sipas rajoneve të caktuara të apelit dhe vendimeve të rajonit të apelit në veçanti, si dhe në nivel kombëtar.

Për mbledhjen e vendimeve të analizuar gjyqësore, kryesisht është përdorur portali i GJSRM, ku janë publikuar vendime anonime gjyqësore, në 95% të vendimeve janë gjetur në këtë portal, ndërsa disa vendime janë përdorur nga praktika e avokatit, kryesisht ato që janë përdorur për analiza nga aspekti i barazimit dhe të cilat lidhen me një çështje juridike për të cilën ekziston praktikë gjyqësore ose pikë reper.

Në procesin e hulumtimit, si dhe marrjen e të dhënave përkatëse për nevojat e hulumtimit, duhet të theksohet fakti që pavarësisht adresimit në gjykata, në formë zyrtare, te shërbimet e tyre të ngarkuar për sigurimin e informacioneve të disponueshme për publikun, nuk kishte asnjë bashkëpunim dhe përgjigje ndaj kërkesave të dorëzuara, që që në aspektin kohor e vazhdoi procesin e hulumtimit dhe analizës.



1

**ANALIZA
E KUALITETIT TË VENDIMEVE
GJYQËSORE NË SFERËN
E TË DREJTËS CIVILE**

Treguesit në bazë të të cilave u bë analizë kualitative e vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore dhe të apelit:

- Struktura e vendimit gjyqësor;
- Sentencë;
- Koherencë;
- Silogjizëm juridik gjatë shkrirjes (përfshirjes);
- Shpjegimi i historisë së çështjes;
- Prezantimi i lëndës/çështjes;
- Gjendja faktike dhe procedura e provave;
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta;
- Qartësia dhe konsistenca e arsyetimit;
- Korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor;
- Udhëzime të qarta në gjykatën themelore gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim;
- Janë cekur qartë arsyet e anulimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës;
- Nëse ato ndryshohen nga vëllimi i apelit ose lartësia e sanksionit, në arsyetimin është cekur qartë pse është bërë ndryshimi në vlerësimin me gjykatën themelore;
- U jepet përgjigje ankesave;
- Nuk përcaktohet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë;
- Gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit ka të gjitha karakteristikat në përcaktimin e gjendjes faktike, analizës së provave, cekjen e së drejtës materiale dhe arsyetimin, si dhe për çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë, (në rastin e tillë, vlejné regullat për analizën e kualitetit të vendimit gjyqësor, si dhe ato të vendimeve gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë - të cekura më lart dhe janë përshkruar në pjesën e analizës kualitative);
- Vendimet e gjykatës së apelit, me të cilat refuzohet ankesa, ka arsyetim vetëm në ato ankesa, të cilat nuk janë cekur më parë për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit i kushton vëmendje afatit për parashkrim absolut kur duhet të vendosë gjykata e shkallës së parë.

1.1 MOSTËR PËR ANALIZË

Gjatë analizës së vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës civile, u analizuan gjithsej 88 vendime në fushën e të katër rajoneve të apelit, duke përfshirë vendimet e gjykatave themelore dhe vendimet e gjykatave të apelit, në përputhje me udhëzimet e dhëna në metodologjinë. Të gjitha vendimet janë sjellë në periudhën prej 01.01.2017 deri më 31.12.2020, me përjashtim të një vendimi që u soll në fillim të vitit 2021.

Në aspekt të cilësisë së vendimeve gjyqësore, u krye një analizë e gjithsej 10 vendimeve të Gjykatës së Apelit Manastir dhe për pesë prej tyre u është bërë analizë nga aspekti i kualitetit të vendimeve dhe një analizë të barazimit. Ndërsa, 10 vendime gjyqësore nga rajoni apelit të Gjykatës së Manastirit të gjykatave themelore janë analizuar në aspektin e kualitetit, ndërsa prej tyre 7 janë analizuar në lidhje me barazimin e tyre.

Në rajonin e Gjykatës së Apelit Shkup, nga aspekti i kualitetit të vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore, janë analizuar 16 vendime gjyqësore, ndërsa nga aspekti i barazimit të tyre, janë analizuar 12 vendime gjyqësore. Janë analizuar 12 vendime të Gjykatës së Apelit Shkup, nga të cilat të gjithë 12 nga aspekti i kualitetit të vendimeve të miratuara, ndërsa 7 prej tyre janë analizuar nga aspekti i barazimit.

Gjithsej 8 vendime të Gjykatës së Apelit Gostivar janë analizuar në Gjykatën e Apelit Gostivar. Nga vendimet, 4 vendime u analizuan vetëm për nga kualiteti i tyre dhe 4 vetëm për nga barazimi i tyre. Nga vendimet e këtij rajoni të apelit të Gjykatave Themelore, janë analizuar gjithsej 12 vendime, 8 për në aspekt të kualitetit të vendimit gjyqësor dhe 8 në aspekt të barazimit të tyre, me atë që disa vendime të analizuara sipas të dyja kriterëve, dhe disa vetëm sipas një kriteri, kualiteti i vendimit ose barazimit.

Nga rajoni i Gjykatës së Apelit Shtip janë analizuar 4 vendime të Gjykatës së Apelit në aspekt të kualitetit dhe 4 vendime në aspekt të barazimit të tyre, ndërsa me aktgjykimet këtij rajoni të apelit të gjykatave themelore janë analizuar 8 vendimet në aspekt të kualitetit, ndërsa vetëm në bazë të barazimit janë analizuar 4 vendimet e gjykatave themelore.

1.2 ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE TË RAJONEVE TË APELIT

1.2.1 Kualiteti i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Manastir

Indekset e cilësisë së vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore nga Rajoni i apelit dhe vendimeve të Gjykatës së Apelit Manastir sipas analizave të kryera janë si vijojnë: 5.00, 5.09, 5.09, 5.18, 5.18, 5.09, 5.18, 4.63,4.72, 5.09, 4.8, 5.00, 5.00, 5.00 dhe 5.14;

Analiza tregon se nëse nxjerrim mesataren për gjithë rajonin e apeleit, fitohet indeksi 5.

Sa i përket analizës së kualitetit të këtyre vendimeve gjyqësore, nga analiza e tyre individuale e çdo vendimi në veçanti mund të konstatohet se në përgjithësi të gjitha vendimet kanë strukturë të drejtë, të gjithë janë me sentenca të qarta dhe në parim nuk bien në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, pa dallim të silogjizmit juridik gjatë supsumcionit, përkatësisht edhe kur në raportin juridik konkret nuk është zbatuar në mënyrë më adekuate ndonjë normë gjykatat qëndrimin e tyre për këtë çështje e mbështesin deri në fund të vendimit me koherencë të sentencës me arsyetimin e dhënë.

Këtu bie në sy një vendim gjyqësor i miratuar nga Gjykata Themelore Krushevë, ku është e pazakontë dhe e palogjikshme për padi për përcaktimin e të drejtës së pronësisë, të caktohet vlera e kontestit prej 40.000 denarë. Ligji për taksë gjyqësore dhe Ligji për LPK kanë dispozita të qarta baza e taksës e të cilës merret parasysh kur caktohet vlera e kontestit. Nga ana tjetër, gjykata me siguri e ka kapërcyer fazën e analizës paraprake të padisë, e ai ka mund më së voni deri në caktimin e seancës gjyqësore përgatitore në mënyrë të shpejtë, efikase dhe të përshtatshme ta caktojë vlerën e kontestit dhe ta ngarkojë padinë për të paguar taksën gjyqësore në pajtim me të gjitha rajonet e apelit, e në secilën rajon të apelit veçmas, e për shkak të këtij lëshimi të gjykatës gjatë analizës së cilësisë ka marrë vlerësim më të vogël.

Në parim, të gjitha vendimet kanë supsumsion të plotë dhe të saktë me një postulat të madh dhe përmes deduksionit parime të zbatuara të një postulati të vogël me konkluzion të logjikshëm me të gjithë elementet e nevojshme, kryesisht sqarime koncize dhe të qarta të historikut të çështjes duke me vështrim në nevojat dhe aktivitetet e ndërmarra të gjykatës, dhe pak a shumë në disa vendime në pjesën e parë bëhet një hyrje në çështjen.

Ekziston një përshkrim i qartë i fakteve dhe rrethanave që shpjegojnë thelbin e çështjes, në paragrafë të veçantë duke sqaruar faktet materiale dhe zbatimin e parimeve juridike. Janë cekur vetëm fakte që janë të rëndësishme për sqarimin e vendimit në një numër të madh vendimesh, dhe në disa prej tyre ekziston cekje edhe të fakteve të parëndësishme që e ngarkojnë pa nevojë vendimin.

Gjithashtu, në përgjithësi në mënyrë të duhur është sqaruar çdo pyetje me sqarim të të drejtës materiale. Përmes logjikës deduktive në raste konkrete janë zbatuar rregulla të përgjithshme të caktuara, logjika induktive e përdorur siç duhet, e cila në shumicën e vendimeve mund të zbatohet në një numër të pacaktuar rastesh. Rregullat relevante janë cituar në mënyrë të duhur në lidhje me secilin kontest konkret.

Faktet konkrete të vendimeve të Gjykatës themelore të këtij rajoni përkojnë me atë që kërkohet nga e drejta materiale dhe në lidhje me të prodhojnë pasojën juridike të përfshirë në aktgjykim. Provat e dhënë janë vetëm ato që janë në funksion të këtyre vendimeve. Vendimet karakterizohen edhe me vlerësim të duhur të secilës provë veç e veç dhe të gjitha pjesëve të provave së bashku si një tërësi e provës. Në aspekt të kualitetit të provave janë kryesisht autentike, të besueshme dhe të konsekuente, ndërsa faktet e jorelevante janë në numër shumë të vogël.

Kryesisht në të gjitha vendimet janë sqaruar argumentet e palës që e ka humbur këtë kontest duke krahasuar argumentet e palës që fitoi kontestin, duke i vendosur ato në korrelacion me gjendjen faktike dhe me zbatimin e të drejtës materiale.

Përmes analizës detektohet se, arsyetimet janë koncize pa detaje të panevojshme, në shumicën e vendimeve nuk ka kopje të procesverbaleve nga diskutimet, provat janë sqaruar plotësisht, jo vetëm të përshkruara nga procesverbali, pohimet e palëve janë sublimuar dhe rrallë kopjohen nga procesverbali. Janë arsyetuar hollësisht aktvendimet për shpenzime me analogji, e cila në një pjesë të vogël të vendimeve ka një animozitet të theksuar ndaj shpenzimeve të avokatit. Për shembull, në vendimin e një gjykate themelore nga Gjykata e Apelit në Manastir, gjykata nuk ka pranuar shpenzimet e përpilimit të një kërkesë për gjetje dhe mendim ekspertit, duke konsideruar se është shpenzim i panevojshëm, njëkohësisht duke mos iu përgjigjur pyetjes së lidhjes shkak-pasojë ndërmjet kërkesës dhe përgatitjes së gjetjes. Shtrohet pyetja nëse, pa kërkesë zyrtare ndaj ekspertit, është e detyrueshme të kryejë ekspertizën, si dhe rrethanat në të cilat duhet të kryhet ekspertiza, pra cilave pyetje duhet t'u përgjigjet ekspertit në gjetjen dhe mendimin e tij. E njëjta gjë përsëritet në një vendim tjetër të gjykatës themelore nga rajoni i apelit në Manastir. Një shembull edhe më specifik është vendimi i Gjykatës Themelore Manastir, ku sipas mendimit parimor të GJSRMV-së sipas analogjisë gjykata "logjikon" se, nëse avokati nuk ka të drejtë në shpenzimet e transportit, ai nuk ka pasur të drejtë në shpenzimet e mbylljes së zyrës, diçka për të cilën askund nuk përmendet një analogji e tillë, veçanërisht në dëm edhe të një faktori tjetër në procedurat gjyqësore siç janë avokatët.

Në përgjithësi të gjitha aktgjykimet janë të kuptueshme, me paragrafë të shkurtër (sa më shumë që të jetë e mundur, sepse në disa gjykime për shkak të provave të shumta dhe kompleksitetit të situatës faktike paragrafët duhet të jenë të gjatë) lidhje e mirë e mendimeve, secili paragraf shtjellon një temë ose çështje, dhe paragrafët në parim janë koherentë në strukturën e tyre, mbështesin një qëndrim paragraf ose problem nga fillimi deri në fund të paragrafit. Aktgjykimet janë me fjalë dhe fjali gramatikore të sakta me gjuhën maqedonase pothuajse letrare, por edhe me përzierje nga dialekti vendor dhe me një numër të vogël gabimesh teknike, të cilat mund të trajtohen si një dobësi e caktuar, dhe në disa prej vendimeve qartësia dhe konsistenca e sqarimit nuk janë në nivelin në të cilin që mund të jenë.

KONKLUZIONI

Analiza në aspekt të kualitetit të vendimeve të Gjykatës së Apelit në Manastir tregon se në procesin e vendimmarrjes ligjet janë respektuar ligjshmëritë logjike miratimit të tyre. Gjendja faktike konkrete në korrelacion me dispozitat e zbatuara të tsë drejtës pozitive prodhon efekt juridik, siç janë miratuar vendimet për ankesat. Sentencat ndikojnë në përmbajtjen e arsytimeve dhe janë konsistente me to. Arsyetimet janë koherente dhe janë të logjikshme argumentet e sentencave, si dhe procedura e vendimmarrjes dhe rregullat e arsytimit gjyqësor. Përveç kësaj, vendimet në përgjithësi janë të kuptueshme pa teorizime të panevojshme. Paragrafët janë të shkurtër, të qartë, dhe fjalitë janë të lidhura në mënyrë të përshtatshme. E gjithë ideja e vendimeve bartet nga fillimi deri në fund të vendimit. Ekziston një unitet i paragrafëve me argumentim të plotë. Fjalitë në aspektin gramatikor janë të saktë në gjuhën letrare maqedonase dhe pa gabime teknike. Në të gjitha vendimet, përgjigjet janë dhënë për të gjitha ankesat e palëve, me arsyetim pse pranohen, përkatësisht nuk pranohen, dhe gjendja faktike sipas rregullit nuk është përshkruar nga vendimi i gjykatave të shkallës së parë, por ekspozohet në mënyrë përshkruese nga Gjykata e Apelit.

1.2.2 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Gostivar

Indekset e kualitetit të vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore nga rajoni i Apelit dhe Gjykata e Apelit Gostivar sipas analizave të kryera janë këto: 5.18, 5.00, 4.36, 4.90, 5.09, 5.09, 5.18, 5.18, 4.57, 4.8, 4.8 dhe 4.8.

Nëse llogaritet mesatarja e të gjitha vendimeve të analizuarra për këtë rajon të apelit, do të fitohet mesatare prej **4.91 IK** do të fitohet në nivelin e rajonit të Gjykatës së Apelit Gostivar.

Lidhur me analizën e kualitetit të këtyre vendimeve gjyqësore nga analiza e tyre individuale e secilit vendim veçmas, mund të konstatohet se në përgjithësi të gjitha vendimet kanë

strukturën e duhur, të gjithë janë me sentenca të qarta dhe në parim nuk kundërshtojnë arsyetimin e dhënë, pavarësisht nga silogjizmi juridik gjatë supsumcionit, përkatësisht kur në raportin juridik konkret nuk është aplikuar në mënyrë më adekuate ndonjë normë, gjykatat mbështesin qëndrimin e tyre për atë çështje deri në përfundimin e vendimit me koherencën e sentencës me arsyetimin e dhënë.

Në parim, të gjitha vendimet kanë supsumcion të plotë dhe të drejtë me një postulat të madh dhe përmes deduksionit të parimeve të zbatuara të një postulati të vogël me një përfundim të fituar logjikisht me të gjithë elementet e nevojshme, kryesisht sqarime koncize dhe të qarta të historikut të çështjes me vështrim në nevojat dhe aktivitetet e ndërmara të gjykatës, dhe pak a shumë te disa vendime që në pjesën e parë bëhet një hyrje në pyetje.

Ekziston një përshkrim i qartë i fakteve dhe rrethanave që sqartojnë thelbin e lëndës, në paragrafë të veçantë duke dhënë një sqarim të fakteve materiale dhe zbatimit të parimeve ligjore. Janë cekur vetëm fakte që janë të rëndësishme për shpjegimin e vendimit në një numër të madh vendimesh, e në disa prej tyre ekziston edhe cekja e fakteve të parëndësishme që e ngarkojnë pa nevojë vendimin.

Përrjashtim nga vendimet e analizuara nga ky rajon i apelit është një vendim i gjykatës themelore, ku mund të vërehet se faktet janë përshkruar shumë gjatë, ku ka përshkrim të deklaratave nga procesverbalet e dëshmitarëve dhe palëve, përkatësisht ku arsyetimi i momenteve është shumë i gjatë me shumë detaje të panevojshme, duke kopjuar procesverbalin e diskutimeve, dëshmitë janë sqaruar, me sqarim për kërkesën e refuzuar. Analiza tregon se pretendimet e palëve nuk janë sublimuar, me përgjigje ndaj kundërshtimeve të palës së kundërt, por e gjithë kjo ka mund të jetë më e shkurtër dhe më e qartë duke u kushtuar vëmendje vetëm çështjeve thelbësore të nevojshme për miratimin e një aktgjykimi të qartë, të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjithashtu, sipas analizës së bërë, shihet se në përgjithësi, te të gjitha aktgjykimet janë sqaruar drejt normat juridike për secilën çështje me sqarim të së drejtës materiale. Përmes logjikës deduktive janë zbatuar rregulla të përgjithshme të caktuara në raste konkrete, logjikë induktive e përdorur në mënyrë të drejtë, e cila në shumicën e vendimeve mund të zbatohet në një numër të pacaktuar rastesh. Janë cituar në mënyrë të drejtë rregullat relevante në lidhje me secilin kontest konkret.

Faktet në fjalë të vendimeve të Gjykatave themelore në këtë rajon korrespondojnë me atë që kërkohet nga e drejta materiale dhe në lidhje me të prodhojnë pasoja juridike të përfshira në aktgjykim. Dëshmitë e dhënë janë vetëm ato që janë në funksion të këtyre vendimeve. Vendimet karakterizohen edhe me vlerësim të saktë të secilës dëshmi veçmas dhe të gjitha dëshmitë si një tërësi dëshmuese. Në aspekt të kualitetit të dëshmitë kryesisht janë autentike, të besueshme dhe konsekuente, dhe faktet jorelevante janë në numër shumë të vogël.

Kryesisht në të gjitha vendimet janë sqaruar argumentet e palës që ka humbur këtë kontest duke krahasuar argumentet e palës që ka fituar kontestin, duke i vendosur ato në korrelacion me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale.

Në vendimet gjyqësore, arsyetimet janë koncize pa detaje të panevojshme, në pjesën më të madhe të vendimeve nuk ka kopjim të procesverbaleve të diskutimeve, dëshmitë janë sqaruar plotësisht, e jo vetëm të përshkruara nga procesverbalet, pohimet e palëve janë sublimuar, e rrallë kopjohen nga procesverballi. Janë arsyetuar hollësisht arsyetimet e shpenzimeve, me përjashtim të disa vendimeve.

Në përgjithësi, të gjitha aktgjykimet janë të kuptueshme, me paragrafë të shkurtër (sa më shumë që të jetë e mundur, sepse në disa aktgjykime për shkak të materialit të vëllimshëm të dëshmimeve dhe kompleksitetit të gjendjes faktike paragrafët duhet doemos të jenë të gjatë) me koherencë të mendimeve, secili paragraf trajton një temë ose çështje, dhe paragrafët në parim janë koherentë në strukturën e tyre, mbështesin një qëndrim ose problem nga fillimi deri në fund të paragrafit. Aktvendimet janë me fjalë të sakta gramatikore dhe fjali me gjuhë pothuajse letrare maqedonase, me më pak përzierje nga dialekti vendor dhe me një numër të vogël gabimesh teknike.

Një vendim nga ky rajon i apelit spikat me kualitetin e vet për shkak se gjendja faktike është përshkruar nga ajo që e ka dhënë Gjykata themelore, dhe është normale që nuk ka nevojë për një gjë të tillë, gjendja faktike mund të paraqitet e sublimuar pa kopjim, përkatësisht përshkrim, më së shumti për shkak të hapësirës dhe kuptimit më të lehtë të gjendjes faktike. Më tutje, edhe një vërejtje tjetër është gjatësia e tepërt e paragrafëve që mund të shmanget duke sublimuar mendimet, paraqitjen e tyre koncize dhe të saktë, në mënyrë që të arrihet një qartësi më e madhe e arsyetimit. Te ky vendim mund të vërehet se disa paragrafë të gjendjes faktike përsëriten edhe disa herë, pa ndonjë nevojë dhe kështu e bën këtë gjykim të gjatë dhe jo shumë të kuptueshëm, prandaj ka marrë nota të ulëta për kriterin e qartësisë dhe konsistencës së arsyetimit dhe për kriterin nëse gjendja faktike thjesht përshkruhet nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

KONKLUZION

Konstatimi për kualitetin e vendimeve të gjykatave themelore në rajonin e apelit Gostivar u referohet kryesisht vendimeve të Gjykatës së Apelit Gostivar, me atë që në pjesën e specifikimeve të vendimit të Gjykatës së Apelit, përfshihen edhe karakteristikat përkatësisht treguesit edhe për vendimet e tilla, e kjo është se janë respektuar ligjshmëritë logjike gjatë miratimit të vendimeve. Gjendja faktike konkrete në korrelacion me dispozitat e zbatuara të së drejtës pozitive prodhon efekt juridik, siç janë miratuar vendimet për ankesat. Sentencat në vendimet gjyqësore ndikojnë në përmbajtjen e arsyetimeve dhe janë konsistente me to. Arsyetimet janë koherente dhe janë të logjikshme argumentet e sentencave, si dhe procedura e vendimmarrjes dhe rregullat e arsyetimit gjyqësor. Vendimet janë të kuptueshme në përgjithësi pa teoretizime të panevojshme. Paragrafët janë të shkurtër, të

qartë, dhe fjalitë janë të lidhura në mënyrë të përshtatshme. E gjithë ideja e vendimeve bartet nga fillimi deri në fund të vendimit. Ekziston një unitet i paragrafëve me argumentim të plotë. Fjalitë në aspektin gramatikor janë të saktë në gjuhën letrare maqedonase dhe pa gabime teknike. Në të gjitha vendimet janë dhënë përgjigje ndaj gjitha ankesave të palëve, me arsyetim pse pranohen, përkatësisht nuk pranohen, ndërsa gjendja faktike sipas rregullit nuk përshkruhet nga vendimi i gjykatave të shkallës së parë, por është arsyetuar në mënyrë përshkruese nga Gjykata e Apelit.

1.2.3 Kualiteti i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Gostivar

Vlerësimet sasiore të marra për secilin aktgjykim të analizuar në rajonin e Gjykatës së Apelit Shkup mbi vendimet e gjykatave themelore duket kështu: 1.45, 5.09, 5.18, 5.18, 4.54, 5.18, 4.7, 5.18, 5.00, 5.18, 5.18, 4.54, 5.18, 5.18, 5.18 dhe 5.18;

Mesatarja që fitohet si rezultat i analizës në aspekt të kualitetit të vendimeve është 4.82 IK.

Gjatë analizës së kualitetit të vendimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit Shkup, janë fituar këto rezultate: 4.6, 4.8, 4.4, 3.0, 4.4, 5.14, 3.6, 4.8, 4.8, 4.8 dhe 4.8;

Mesatarja që fitohet në aspekt të analizës së kualitetit të vendimeve është 4.46, IK, ndërsa mesatarja e përgjithshme për të gjithë rajonin e Gjykatës së Apelit Shkup dhe për vendimet e edhe të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit është 4.67.

Në nivel global, duke pasur parasysh rezultatet fituara në aspekt të kualitetit të vendimeve, e në interes të hapësirës në këtë raport, janë cekur të gjitha karakteristikat e vendimeve të gjykatave nga rajoni i gjykatës së Manastirit dhe Gostivarit, në përgjithësi janë përfshirë edhe në këtë analizë të vendimeve të gjykatave themelore në rajonin e Gjykatës së Apelit Shkup.

Vihet re se një vendim praktikisht zvogëlon mesataren e indeksit të kualitetit, vendim i Gjykatës Themelore Shkup, i cili trajton problemin e përdoruesve të shlyer nga energjia termike. Ndoshta ky koment do të prekë në mënyrë të arsyeshme pjesën e analizës dhe në aspekt të barazimit të vendimeve gjyqësore nga pjesa tjetër e analizës, por këto dy kritere të analizës megjithatë janë të lidhura në mënyrë thelbësore dhe në fund japin një tërësi dhe karakteristikë të gjithë vendimit gjyqësor.

Analiza tregon se, për një praktikë të pazakontë, mund të konsiderohet faktori që, i padituri në këtë procedurë i është referuar faktit se neni 52, paragrafi 3 është shfuqizuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga 04.02.2009, kështu që vendimet e miratuara në bazë të kësaj dispozite s'mund të prodhojnë veprime

juridike, dhe nëse ekzekutimi ka filluar ai duhet të ndalet. I padituri gjithashtu është thurur në të dhënat personale, sepse ai asnjëherë nuk ka lidhur marrëveshje, përkatësisht nuk ka hyrë në marrëdhënie obligative me paditësin, por gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë këtë si fakt vendimtar gjatë miratimit të aktgjykimit dhe gjatë supsumpcionit gjendjes faktike sipas normave juridike pozitive në rendin juridik të RMV-së. Në fund të fundit, ka qenë e mjaftueshme, sepse vendi ynë ka ratifikuar KEDNJ, gjykata themelore që e ka miratuar këtë vendim të thirret drejtpërdrejt në konventën, por edhe shumë dispozita të Ligjit aktual për marrëdhënie obligative mund të zbatohen në këtë rast konkret siç ka përcaktuar më vonë edhe GJSRMV në mendimin juridik parimor nga 20.02.2018. Ky është vetëm një shembull për analizë, dhe sipas informacionit që kam në dispozicion për momentin, bëhet fjalë për 10 dhe 20 mijë familje, të cilat me kërkesën e tyre janë shkyçur nga sistemi i ngrohjes të paditësit dhe këto fatura qytetarët ose i paguajnë për të shmanhur procedurat gjyqësore ose ballafaqohen vazhdimisht me procedura të tilla gjyqësore, sepse çdo dy deri në tre muaj paditësi dorëzon fatura dhe urdhërpagesa të Noterit tek noterët kompetentë.

Megjithëse, kjo duket si kontest i parëndësishme ose me të vogël, pothuajse e pakonsiderueshme, nga ana tjetër numër i madh i qytetarëve janë prekur me miratimin e vendimeve të tilla, e në instancë të fundit mënyra e tillë e drejtësisë krijon përshtypjen e një numri të madh të qytetarëve për padrejtësi, veçanërisht për lëndë të kontestit prej afro 1.000.00 deri në 1.500.00 denarë dhe pas shpenzimeve të zvogëluara gjyqësore në fund me shpenzimet të noterit, përmbauese dhe të avokatit qytetari për një lëndë të tillë paguan rreth 10.000.00 denarë për një rast të tillë.

Se mënyra e tillë e vendimmarrjes është në kundërshtim me logjikën e shëndoshë juridike dhe aktgjykimin e GJEDNJ-së për aplikimin e paditësit Strezovski kundër RMV-së, ku gjykata ka konstatuar se me veprimin e tillë të të paditurit i janë shkelur të drejtat themelore të njeriut, por për atë më poshtë në këtë analizë. Prandaj, ky vendim praktikisht prish mesataren e vendimeve të gjykatave themelore në këtë rajon të apelit, sepse ka marrë vlerësime më të ulëta për kriterin e silogjizmit juridik gjatë supsumcionit, për sqarim të historikut të çështjes, prezantim të çështjes (subjekti i mosmarrëveshjes), për prezantimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore dhe parimeve juridike, shqyrtim dhe vlerësim të argumenteve, dhe në përgjithësi sipas kriterëve të tjera vlerësohet si një aktgjykim me kualitet nënmesatar.

Vendim i tillë i Gjykatës së Apelit në Shkup është vendimi në të cilin Gjykata e Apelit në Shkup u përgjigjet pohimeve të papranueshme për ankesë në kontestin me me vlerë të vogël, për pretendimet për shkak të gjendjes faktike të konstatuar gabimisht me çrast pas disa kriterëve ky vendim mori vlerësime të ulëta, kështu që vlerësimi i përgjithshëm i këtij vendimi, përkatësisht IK është 3.0.

Nga ana tjetër, një vendim i Gjykatës së Apelit Shkup spikat nga vendimet e tjera për nga kualiteti e tij dhe sipas të gjitha kriterëve për analiza në aspekt të kualitetit të vendimit të

gjykatës ka marrë vlerësimet më të larta dhe ai është vendimi që ka fituar në total IK 5.14 dhe është një shembull shkollor se si duhet të duket si një vendim gjyqësor i Gjykatës së Apelit.

KONKLuzion

Sa i përketës analizës së kualitetit të këtyre vendimeve gjyqësore nga analiza e tyre individuale e secilit vendim veçmas, mund të konstatohet se në përgjithësi të gjitha vendimet kanë strukturën e duhur, të gjithë janë me sentenca të qarta dhe në parim nuk kundërshtojnë arsyetimin e dhënë, pavarësisht nga silogjizmi juridik gjatë supsumcionit, koherencës së sentencës me arsyetimin e dhënë.

Në parim, të gjitha vendimet kanë supsumcion të plotë dhe të drejtë me një postulat të madh dhe përmes deduksionit të parimeve të zbatuara të një postulati të vogël me një përfundim të fituar logjikisht me të gjithë elementet e nevojshme, kryesisht sqarime koncize dhe të qarta të historikut të çështjes me vështrim në nevojat dhe aktivitetet e ndërmara të gjykatës, dhe pak a shumë të disa vendime që në pjesën e parë bëhet një hyrje në çështjen.

Ekziston një përshkrim i qartë i fakteve dhe rrethanave që sqarojnë thelbin e lëndës, në paragrafë të veçantë duke dhënë një sqarim të fakteve materiale dhe zbatimit të parimeve ligjore. Janë cekur vetëm fakte që janë të rëndësishme për shpjegimin e vendimit në një numër të madh vendimesh, e në disa prej tyre ekziston edhe cekja e fakteve të parëndësishme që e ngarkojnë pa nevojë vendimin.

Të gjitha karakteristikat e mësipërme të vendimeve të gjykatave në rajonin e gjykatave të Manastirit dhe Gostivarit përgjithësisht janë përfshirë në këtë analizë të vendimeve të Gjykatave Themelore në rajonin e Gjykatës së Apelit Shkup, si dhe vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkup.

1.2.4 Kualiteti i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Shtip

Nga analiza e kualitetit të vendimeve të gjykatave nga rajoni i i apelit Shtip fitova këto rezultate: 5, 4.8, 5.18, 5.18, 5.18, 5.18, 4.9, 4.88 dhe 4.27 nga gjykatat themelore në këtë rajon.

Ndërsa, nga vendimet e Gjykatës së Apelit në Shtip i marra këto rezultate: 4.42, 2.6, 4.8 dhe 5.14;

Mesatarja e përgjithshme e të gjitha vendimeve të analizuara në nivelin e rajonit të Gjykatës së Apelit Shtip të marra në bazë të kualitetit të vendimeve gjyqësore është 4.73 IK.

Edhe këtu, si në rajonet paraprake të apelit, është e pakontestueshme që vendimet gjyqësore kanë strukturë të logjikshme me të gjitha elementet e nevojshme, arsyetimet në parim janë koherente dhe nuk ka arsytetime që janë në kundërshtim me sentencën, përkatësisht e mbështesin nga vetë fillimi deri në fund të arsytimit.

Logjika juridike te vetëm disa prej këtyre vendimeve nuk është në nivelin që duhet të jetë, konkretisht te vendimi i një gjykate themelore në këtë rajon të apelit, ku është evidente se gjykata ka humbur fazën e analizës paraprake të padisë dhe mënjanimit të mangësive formale, përkatësisht caktimit të vlerës së kontestit nga i cili varet përbërja e gjykatës, e drejta e deklarimit të revizionit, shuma e taksace gjyqësore, shuma e shpenzimeve të procedurës. Ndoshta, në këtë rast ky ndikim i mos përcaktimit të vlerës së vërtetë të subjektit të lëndës së kontestit nuk janë të gjitha këto pasoja, por në fund të fundit, me vlerën e ulët që nuk korrespondon me lëndën e kontestit dëmtohet buxheti i RMV-së.

Sipas analizës, duke mënjanuar këtë praktikë do të arrihet edhe barazimi në kuptim të asaj se për shkak të kësaj do të hasen raste në praktikë ku për një vlerë të njëjtë faktike të kontestit, njëra palë do të paguajë shpenzime më të ulëta, ndërsa pala tjetër do të ekspozohet ndaj shpenzimeve dukshëm më të larta.

Gjithashtu, në një farë mënyre, është shqetësues vendimi që sipas analizës së kualitetit të tij ka IK prej 2.6. Shumë punë dhe çështje të kontestueshme juridike të cilat ankuesi i ka theksuar në ankesën janë neglizhuar nga gjykata, dy fëmijë nga martesë e palëve janë lënë pa asnjë mbështetje dhe përfundimisht gjykata ka mundur në interes të fëmijëve të mitur dhe me detyrë zyrtare t'i marrë dokumentet e nevojshme dhe të zgjidhë përfundimisht dhe plotësisht të gjitha dilemat në lidhje me këtë. Gjithashtu, është i pakuptueshëm mënyra e pagesës së mbështetjes e cila për hirë të së vërtetës, është përcaktuar shumë ulët pa dallim të statusit të të paditurit në lidhje me punësimin e tij. Në shekullin 21, epoka e elektronikës dhe bankës online, gjykata komenton se në ligjin nuk është caktuar mënyra në të cilën i padituri do të bëjë pagesën. Edhe po të mos jetë caktuar mënyrë të pagesës në ligjin, duke pasur parasysh kushtet e sotme, kjo mund të konsiderohet si një vakum juridik dhe gjykata këtu duhej të bënte përpjekje dhe një hap drejt kryerjes më të lehtë të detyrimeve në bazë të mbështetjes. Gjatë të menduarit logjik, lind pyetja, si do të dukej të paguash me para në dorë detyrimin për mbështetje.

Për shkak të të gjitha këtyre lëshimeve, vlerësohet se gjykata duhet të jetë në shërbim të qytetarëve, ndërsa pavarësisht vakumeve juridike për të gjetur mënyrë që mund të lehtësojë detyrimet e qytetarëve që rrjedhin nga vendimet e gjykatave, por gjithë kjo të përshtatet në kohë reale, dhe në përputhje me mënyrën aktuale të jetesës dhe veprimit të të gjithë subjekteve.

Lidhur me trajtimin dhe veprimin për kontestet e punës në këtë rajon të apelit, konkludohet se janë trajtuar në mënyrë adekuate këto konteste me numër të vogël të përjashtimeve.

KONKLUZION

Konstatimi për kualitetin e vendimeve të gjykatave themelore në rajonin e apelit Shtip u referohet kryesisht edhe vendimeve të Gjykatës së Apelit Shtip, me atë që në pjesën e specifikimeve të vendimit të Gjykatës së Apelit, përfshihen edhe karakteristikat përkatësisht treguesit edhe për vendimet e tilla, e kjo është se janë respektuar ligshmëritë logjike gjatë miratimit të vendimeve. Gjendja faktike konkrete në korrelacion me dispozitat e zbatuara të së drejtës pozitive prodhon efekt juridik, siç janë miratuar vendimet për ankesat. Sentencat në vendimet gjyqësore ndikojnë në përmbajtjen e arsytimeve dhe janë konsistente me to. Arsyetimet janë koherente dhe janë të logjikshme argumentet e sentencave, si dhe procedura e vendimmarrjes dhe rregullat e arsyetimit gjyqësor. Vendimet janë të kuptueshme në përgjithësi pa teoretizime të panevojshme. Paragrafët janë të shkurtër, të qartë, dhe fjalitë janë të lidhura në mënyrë të përshtatshme. E gjithë ideja e vendimeve bartet nga fillimi deri në fund të vendimit. Ekziston një unitet i paragrafëve me argumentim të plotë. Fjalitë në gjuhën letrare maqedonase janë gramatikisht të sakta pa gabime teknike, ndoshta në një masë më të madhe sesa rajonet tjera të apelit. Në të gjitha vendimet janë dhënë përgjigje ndaj gjitha ankesave të palëve, me arsyetim pse pranohen, përkatësisht nuk pranohen, ndërsa gjendja faktike sipas rregullit nuk përshkruhet nga vendimi i gjykatave të shkallës së parë, por është arsyetuar në mënyrë përshkruese nga Gjykata e Apelit.

1.3 KUALITETI I VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVEL KOMBËTAR

Nga analiza kuantitative dhe fitimi i rezultateve për IK, siç është paraqitur më lart, sipas rajoneve të apelit të katër gjykatave të apelit në vend janë fituar rezultatet në vijim:

- rajoni i apelit të Gjykatës së Apelit Manastir IK - 5.00;
- rajoni i apelit të Gjykatës së Apelit Gostivar IK - 4.91;
- rajoni i apelit të Gjykatës së Apelit Shkup IK - 4.91; dhe
- rajoni i apelit të Gjykatës së Apelit Shtip IK - 4.91;

Sipas rezultateve të fituara, Ik në nivel kombëtar është **4,82**.

Nëse e kemi parasys metodologjinë e këtij hulumtimi, si dhe vendimet e zgjedhura rastësisht për analizë nga të gjitha rajonet e apelit në RMV, të cilat mund të konsiderohen si një përfaqësues i përshtatshëm i të gjitha vendimeve gjyqësore, është i kënaqshëm rezultati në nivel kombëtar.

Nga aktgjykimet e publikuara, të cilat janë zgjedhur rastësisht nga portali i GJSRMV-së, fitohet përshtypja se megjithatë presioni më i madh i gjykatave, në kuptim të numrit të çështjeve është në rajonin e apelit të Gjykatës së Apelit në Shkup, sipas numrit të aktgjytimeve të publikuara. Ky nuk është një arsyetim për rezultatin e marrë, sepse këto janë dallime mjaft të vogla dhe të nuancuara në krahasim me rajonet tjera të apelit, por megjithatë ngarkesa me numër të madh të lëndëve nuk mund të krahasohet me gjendjen faktike në terren, ku gjykatës të caktuar në vendet më të vogla kanë lëndë mujore aq sa vendos një gjykatës në Shkup për një ditë.

Në nivel kombëtar, është absolutisht tanimë çështja, përkatësisht kriteri se si duhet të duket një vendim gjyqësor për nga forma dhe struktura e tij, dhe ky parametër respektohet përgjithësisht në të gjithë vendin, nga të katër rajonet e apelit.

Një element i rëndësishëm që duket gjykatat, e veçanërisht gjykatat themelore në të gjitha rajonet, e me atë kështu e ndërlikon të gjithë procedurën, është fakti se në shumë raste tejkalohej faza e analizës paraprake të padisë, diçka që është shumë e rëndësishme dhe që kontribuon që në fillim të zgjidhen shumë pengesa të rëndësishme procedurale dhe të fitohet mënyrë më ekonomike dhe më të shpejtë dhe më të barabartë të zgjidhjes së kontesteve gjyqësore. Nëse gjykatat e rregullta themelore praktikojnë rregullisht këtë procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë, procedurat do të ishin shumë më ekspeditivë kështu që ose do të refuzohet padia në këtë fazë ose do të vazhdojë procedura me kritere objektive dhe të barazuara të të gjitha rajonet e apelit. Me këtë, do t'u jepet fund rasteve

ku për problemin e njëjtë juridik, përkatësisht lëndën e kontestit në gjykata të ndryshme do të diskutohet sipas vlerave të ndryshme të kontesteve, dhe do të kontribuojë edhe në barazimin dhe praktikën e vetme gjyqësore.

Logjika juridike është gjithashtu një element përbërës shumë i rëndësishëm i një vendimi gjyqësor. Vetëm në disa vendime nga të gjitha vendimet e analizuara gjyqësore, ka ndodhur që logjika juridike të mos jetë në një nivel të kënaqshëm dhe të bëhet supsumpcion i gabuar, qoftë për shkak të ekzistimit të vakumit juridik, qoftë për shkak të papërshtatshmërisë ose paligjshmërisë së akteve nënligjore që janë në fuqi ose për shkak të neglizhimit të legjislacionit evropian, i cili tashmë duhet të pranohet përgjithësisht dhe në disa raste praktika gjyqësore në lidhje me GJEDNJ të zbatohet më guximshëm për dobësitë e tilla që ekzistojnë në sistemin tonë gjyqësor.

Unë vërtet i kuptoj dilemat që disa gjykatës të caktuar sigurisht i kanë kur duhet të vendoset sipas akteve nënligjore pozitive, te të cilët vërehet se diçka nuk është ashtu siç duhet, nga njëra anë ose nga ana tjetër të "rrezikohet" duke zbatuar praktikën gjyqësore dhe në njëfarë mënyre të miratohet vendim i drejtë, por formalisht i paligjshëm. Nga ana tjetër, për të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore që pak a shumë është e qartë që nuk korrespondojnë me rendin tonë ligjor, më shumë palë të interesuara të sistemit juridik duhet të inkurajohen dhe të paraqesin iniciativa në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së për të korrigjuar rregulla të tilla të cilat me sa duket sistemi i ka tejkaluar ato dhe ata janë "prodhues" vendimesh jocilësorë ose vendime cilësore të cilat qytetari i zakonshëm i ndjen si padrejtësi.

2.

**ANALIZA
E KUALITETIT NË ASPEKT
TË BARAZIMIT TË VENDIMEVE
GJYQËSORENË FUSHËN E SË
DREJTËS CIVILE**

Barazimi i vendimeve gjyqësore, si një nga parakushtet për sigurinë juridike, e me atë edhe sundimi i së drejtës, garantohet në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 101, i cili thotë se Gjykata Supreme në Republikën siguron unitet në zbatimin e ligjeve nga gjykatat. Është e dukshme se Kushtetuta e obligon Gjykatën Supreme për t'u kujdesur për zbatimin e vetëm të ligjeve, por kjo normë kushtetuese përcakton në mënyrë të implicite detyrimin e gjykatave, pavarësisht nga lloji dhe instanca e tyre, për të respektuar këtë rregull, duke u përpjekur të bëjnë balancë ndërmjet lirisë së bindjes gjyqësore dhe zbatimit të vetëm të ligjeve, që nënkupton përshtatje të praktikës ekzistuese.

Ligjvënësi në nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit për Gjykatat, elaboron normën kushtetuese dhe ceket se qëndrimet parimore dhe mendimet kryesore juridike të përcaktuara nga Gjykata Supreme në seancë të përgjithshme janë të detyrueshme për të gjitha këshillat e Gjykatës Supreme. Por, Ligji për Gjykatat nuk parashikon detyrim të tillë për gjykatat më të ulëta dhe lë hapësirë që ky vakum të interpretohet më gjerësisht - që Gjykata Supreme është instanca e fundit dhe gjykatat duhet të përshtaten me standardet dhe praktikën e gjykatës nëse duan që vendimet e tyre gjyqësore të vlerësohen si kualitative, por kjo normë juridike edhe mund të lihet në korrelacion me normën kushtetuese të cituar më parë dhe mund të nxirret një përfundim se në mënyrë implicite këto qëndrime parimore dhe mendime parimore juridike duhet të jenë të detyrueshme edhe për gjykatat më të ulëta.

Në nenin 66 të Rregullores së punës është parashikuar të formohen seksione për praktikën gjyqësore. Neni 19 parashikon që kryetari i gjykatës, nëse në punën e seksioneve, këshillave gjyqësore dhe gjykatësve individualë vëren veprim i pabarabartë ose veprim në kundërshtim me rregullat ose shmangie nga praktika e vendosur gjyqësore e gjykatave më të larta, paraqet propozim me shkrim që të shqyrtohen në seancë të seksionit ose Seksionit të Specializuar Gjyqësor.

Sipas nenit 72, gjatë përpunimit shfrytëzohen të dhënat nga sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore, dhe vendimet e miratuara të plotfuqishme të rëndësishme të sistematizuara sipas fushave juridike gjykatat i publikojnë në buletin të paktën një herë në vit.

Seksioni për praktikë gjyqësore i Gjykatës Supreme, punon në sigurimin e zbatimit të vetëm të ligjit, merr pjesë në përgatitjen e propozim (draft) qëndrimeve parimore dhe mendimeve parimore juridike në seancën e përgjithshme, pas sugjerimit nga gjykatat më të ulëta për atë nëse vendimi i caktuar është në pajtim me qëndrimin juridik të shprehur në ndonjë vendim të mëparshëm ose të njëkohshme kryen kontroll të vendimeve të Gjykatës Supreme, ndërsa e ndjek dhe studion praktikën gjyqësore të gjykatave më të ulëta, përmes vendimeve të disponueshme për çështje të caktuara juridike.

Në bazë të Rregullores së punës të Gjykatës Gjykata Supreme ka edhe trup pune për barazimin dhe ndjekjen e praktikës gjyqësore.

Sipas nenit 75 të Rregullores së punës të Gjykatës, kryetarët e të gjithë seksioneve në gjykatën janë të detyruar që t'i dorëzojnë mendimet juridike dhe konkluzionet te kryetari i seksionit për praktikë gjyqësore ose gjykatësi i ngarkuar për praktikë gjyqësore. Kryetari i seksionit për praktikë gjyqësore e cakton mënyrën në të cilën seksioni për praktikë gjyqësore i evidenton mendimet juridike të pranuar në seancat e përbashkëta të seksioneve ose në seancat e gjykatave. Kryetari i seksionit e cakton mënyrën e evidentimit dhe publikimit të praktikës gjyqësore dhe është në komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e seksioneve të praktikës gjyqësore nga gjykatat tjera.“

Në pajtim me nenin 386 të Ligjit për procedurë gjyqësore, gjykata të cilit lënda i është kthyer për rigjykim është e lidhur me atë çështje me kuptimin juridik në të cilin bazohet aktvendimi i Gjykatës së revizionit me të cilin është shfuqizuar aktgjykimi i shkallës së dytë i hedhur poshtë, përkatësisht me të cilin është shfuqizuar aktgjykimi i shkallës së dytë dhe shkallës së parë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë mund të lejojë revizion duke konkretizuar përfshirjen e çështjes juridike që do të ngrihej para Gjykatës Supreme, nëse vlerëson se vendimi në kontestin varet nga zgjidhja e çështjes juridike-materiale ose çështjes procedurale-juridike e rëndësishme për të siguruar zbatimin e vetëm të ligjit dhe barazimin e praktikës gjyqësore.

2.1 KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS

Për të analizuar kualitetin nga aspekti i barazimit të vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës civile, është bërë analizë e 5 vendimeve të Gjykatës së Apelit Manastir, 7 vendimeve të gjykatave themelore nga rajoni i apelit Manastir ose gjithsej 12 vendime, u miratuan 4 vendime të Gjykatës së Apelit Gostivar, 8 vendime të miratuara nga gjykatat themelore në të rajonit të apelit të Gjykatës së Apelit Gostivar ose gjithsej 12 vendime, 7 vendime të miratuara nga Gjykata e Apelit Shkup, 13 vendime të gjykatave themelore të rajonit të apelit Shkup ose gjithsej 20 vendime, 4 vendime të miratuara nga Gjykata e Apelit Shtip dhe 4 vendime të gjykatave themelore nga rajoni i apelit Shtip ose gjithsej 8 vendime për këtë rajon. Në nivel kombëtar, gjithsej 52 vendime ishin lëndë e analizës për sa i përket barazimit të vendimeve gjyqësore. Disa nga këto vendime u analizuan në aspekt të kualitetit të vendimeve të mësipërme, sepse ato i plotësonin kriteret në të dyja bazat për analiza në përputhje me qëllimet e këtij projekti.

Këto vendime në përputhje me qëllimet dhe detyrat e metodologjisë janë përzgjedhur si vendime që janë miratuar në periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2020 dhe ku njëra nga palët në këto vendime është qytetar përkatësisht qytetarë.

Çështjet juridike që janë përfshirë dhe që ishin të përshtatshme për vëzhgim janë të natyrës më të ndryshme, çështje për të cilat Gjykata Supreme ka mendime parimore ligjore, përkatësisht qëndrime ose sentenca të cilat do të trajtohen më poshtë, janë përcaktim i vlerës së kontestit, kompensimit të dëmit, pagesës së kompensimeve nga marrëdhënia e punës, mendimit juridik parimor për shfrytëzuesit e shkyçur të energjisë termike, rregullsisë së parashtrësive, dhe veçanërisht padisë si parashtrësë fillestare për fillimin e procedurës kontestimore, etj.

U përmend më lart se mosbashkëpunimi i personave përgjegjës dhe të thirrur në të gjitha këto gjykata, vlen edhe për mbledhjen e këtyre vendimeve si dhe vendimeve për analiza kuantitative dhe kualitative dhe këto vendime janë mbledhur nga faqja zyrtare e GJSRMV-së, ku publikohen të njëjtat. Të gjitha këto vendime zgjidhen me përzgjedhje krejt të rastësishme, me vëmendje që për të njëjtit të ketë tashmë praktikë të vendosur gjyqësore, qëndrim, sentencë ose mendim nga GJSRMV-së ose aktgjykim evropian që është miratuar pas kërkesës së qytetarëve tanë.

2.2 ANALIZA E KUALITETIT TË VENDIMEVE NGA ASPEKTI I BARAZIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN E RAJONEVE TË APELIT

2.2.1 Barazimi i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Manastir

Duke analizuar vendimet e miratuara për këtë rajon të apelit sipas treguesve kuantitativë, në aspekt të barazimit të tyre në pajtim me metodologjinë janë fituar rezultatet e mëposhtme: 7.5, 0, 0, 0, 0, 6, 0, 0, 0, 0 dhe 0;

Me tregues të tillë kuantitativë të vendimeve të analizuar fitohet indeks i barazimit që është 1.22 në nivelin e rajonit të apelit Manastir.

Në fakt, nëse krahasojmë rezultatet e fituara kuantitative, sipas këtij kriteri të barazimit në krahasim me analizën në aspekt të kualitetit të vendimeve gjyqësore, do të vërehet menjëherë një ndryshim drastik duke pasur parasysh atë se matjet kuantitative janë caktuar dhe aplikuar në aktgjykimet sipas metodologjisë së njëjtë.

Në vazhdim vijojnë disa vendime nga ky rajon i apelit që janë më karakteristike dhe që do të jenë shembull i përshtatshëm përfaqësues i asaj për atë çfarë është qëndrimi dhe praktika e gjykatave në këtë rajon të apelit.

Një shembull tipik i kësaj është aktgjykimi i analizuar i Gjykatës së Apelit Manastir ku paditësit kanë ngritur kontest për përcaktimin e shkeljes së të drejtës për barazi (diskriminim), shkeljes së të drejtës për lëvizje të lirë brenda dhe jashtë territorit të RMV-së, cenimit të nderit, reputacionit dhe dinjitetit dhe kompensimit të dëmit jomateriale. Gjatë miratimit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit ka përgatitur gjykim jashtëzakonisht kualitativ me tregues të lartë kuantitativë, dhe meqë i padituri thirret në kundërshtimin e bazueshmërisë së kërkesës së padisë të "shengen border kodit", kjo gjykatë merr parasysh këtë rregull, por në mënyrë të bazuar konstaton se rregulli i tillë, meqë nuk është ratifikuar nga RMV-ja nuk mund të jetë lëndë e analizës dhe aplikimit në sistemin tonë juridik dhe në mënyrë të arsyeshme e refuzon zbatimin e tij. Në mënyrë që ky aktgjykim të jetë i plotë dhe të qëndrojë sipas të gjitha kriterëve të analizës sipas këtij projekti, Gjykata e Apelit mund të thirret lirshëm në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga ku mund të nxjerrë norma në kuptim të pranimit të pakundërshtueshëm të kërkesës së padisë të paditësve.

Te një aktgjykim tjetër të së njëjtës gjykatë, lëndë e kërkesës së padisë është kompensimi i dëmit jomaterial për shkak të shkeljes së të drejtave personale, ku ka padi nga paditësi dhe sipas të njëjtës bazë ka një kundërpadi në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për dhimbje të pësuar shpirtërore për shkak nderit dhe imazhit të cenuar, të kryer me parashtrimin e kërkesës së padisë të pabazuar ligjërisht për kompensimin e dëmit joma-

terial sipas Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, nga i padituri. Gjykata e Apelit e ka miratuar këtë aktgjykim në mënyrë mjaft korrekte dhe në bazë të materialit të dëshmimeve në dokumentet e lëndës, por mbetet përshtypja se në mënyrë shumë të turpshme në arsyetimin e vet çeket se në gjendjen e tillë faktike, gjykata e shkallës së parë duke zbatuar dispozitat e nenit 2, 7, 9, 15 dhe 16 të Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, si dhe dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka konstatuar se edhe kërkesa e padisë e paditësit edhe kundërpadia e të paditurit janë të pabazuara dhe ka vendosur në mënyrën si në sentencën e aktgjykimit të kundërshtuar. Këtu, me vetëdije apo pa vetëdije, është anashkaluar zbatimi i arsyetuar më i sigurt, më i qartë dhe më esencial i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me ç'rast aktgjykimi do të jetë i plotë në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Shembulli vijues për moszbatimin e praktikës gjyqësore ekziston në një aktgjykim të Gjykatës së Apelit Manastir ku lëndë e kontestit është kompensimi i dëmit jomaterial, vlera e kontestit 150.000.00 denarë, për shkak të përcaktimit të kompensimit të drejtë monetar për dëmin jomaterial për shkak të shkeljes së të drejtave personale të paditësit, ku dhe krahas ekzistimit të Qëndrimit të përgjithshëm juridik të GJSRMV-së nga 04.03.2016, për dëmin e shkaktuar nga kafshimi i qenit, në këtë rast gjykata nuk është thirrur në këtë paragraf megjithëse ka pasur mundësi, ndërsa arsyetimi në këtë kuptim do të ishte më i qëndruar megjithëse në parim bëhet fjalë për aktgjykim të ligjshëm dhe të drejtë me kualitet të shkëlqyeshëm sipas metodologjisë për analizën e atyre treguesve.

Në vazhdim gjatë analizës së barazimit të aktgjykimit tjetër, ku ekziston mundësia për zbatimin e mendimit juridik parimor të GJSRMV-së nga 20.02.2018, i cili u referohet shfrytëzuesve të energjisë termike që nuk kanë statusin e shfrytëzuesve të shkyçur dhe nuk duhet të paguajnë pjesën fikse të kompensimit për energji termike, kjo gjykatë ka lëshuar mundësinë për të përfshirë këtë mendim juridik parimor ligjor gjatë miratimit të këtij vendimi. Në këtë kuptim, ekziston reper i miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në favor të qytetarëve, të cilët janë të detyruar të paguajnë për ngrohje, edhe pse ata nuk e kanë shfrytëzuar. Sipas GJEDNJ, ankesa është paraqitur nga pronarët e banesave që ankohen se u është imponuar obligikimi në mënyrë të paligjshme që të paguajnë për ngrohjen qendrore në objektet kolektive për banim, pra në ndërtesat në të cilat ata jetojnë, me ç'rast u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara për gëzimin e qetë të pronës, në të cilën thirret edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjatë analizës së vendimeve nga rajoni i apelit të Gjykatës së Apelit Shkupit, tashmë ka disa fillime pioniere të aplikimit përkatësisht respektimit të mendimit juridik parimor të Gjykatës Supreme të RMV-së, dhe gradualisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjen hapësirë për aplikim gjatë miratimit të vendimeve të tilla.

Gjatë miratimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Manastiri ka pasur mundësi duke iu referuar sentencës Rev2.nr.532/2015 që është miratuar më 12.5.2017 për të mbështetur vendimin e tij sepse është mjaft i përshtatshëm dhe trajton të njëjtin prob-

lem juridik që paraqitet në vendimin e kësaj gjykate. Gjegjesisht, në këtë fjali është përcaktuar se shuma minimale e kompensimit për pushimin vjetor në përputhje me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit për marrëdhënie pune në lidhje me Marrëveshjen Kolektive të punëdhënësit në përputhje me nenin 12 të LMP, të drejtat e marrëdhënies së punës të përcaktuara me Kushtetutën, Ligjin dhe Marrëveshjen Kolektive, nuk mund të hiqen ose kufizohen me akte dhe veprime të punëdhënësit konstatohet se shuma e kompensimit për pushim vjetor caktohet me Ligji dhe Marrëveshje kolektive dhe nuk mund të paguhet me shumë më të ulët se shuma e caktuar. Pikërisht në këtë çështje juridike të paditësit ndërmjet pjesës tjetër të kërkesës së padisë për kompensim si pjesë e kërkesës së padisë është pagesa e regresit për pushim vjetor. Punëdhënësi është përpjekur në njëfarë mënyre për ta shmangur shmangur këtë detyrim por me zbatimin e saktë të LMP të paditësit i është pranuar kërkesa e padisë, e me këtë vendim është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë. Këtu, për shkak të argumentimit ende më të fortë mund të thirret nga gjykata në këtë sentencë, sepse e njëjta e trajton plotësisht këtë marrëdhënie juridike.

Vijojnë vendimet e gjykatave themelore nga rajoni i Gjykatës së Apelit Manastir në aspekt të barazimit të tyre dhe si i parë është një vendim që është miratuar nga Gjykata Themelore në Krushevë.

Një moment karakteristik që bie menjëherë në sy është vlera e përcaktuar e kontestit për të cilën LPK dhe ligji për tarifën gjyqësore kanë dispozita sesi përcaktohet, kush duhet ta cekë, përcaktojë, deri kur mund ta përcaktojë dhe ngjashëm. Gjegjesisht, në përputhje me LPK neni 33:

(1) Nëse kërkesa nuk i referohet një shume monetare, por paditësi në padinë ka cekur se ai pajtohet që në vend të përmbushjes së asaj kërkesë të pranojë një shumë të caktuar parash, si vlerë e lëndës së kontestit do të merret ajo shumë.

(2) Nëse kërkesa e padisë u referohet kontesteve pronësore, për të përcaktuar vlerën e kontestit është meritore vlera e qarkullimit të pronës, lëndë e kontestit, të cilën paditësi është i detyruar ta përcaktojë në padinë.

(3) Nëse në rastin nga paragrafi (2) i këtij neni vlerën e lëndës së kontestit paditësi me sa duket e ka përcaktuar atë shumë lartë ose shumë ulët, kështu që parashtron pyetje për përbërjen e gjykatës ose për të drejtën e deklarimit të revizionit, gjykata më së voni deri në caktimin e seancës përgatitore në shpejtë dhe në mënyrë adekuate do ta përcaktojë vlerën e kontestit. Në të gjitha rastet e tjera, kur i kërkesa e padisë nuk i referohet shumës monetare si vlerë e lëndës së kontestit konsiderohet lartësia e bazës së taksës.

Në Ligjin për taksat Gjyqësore Kapitulli III. PËRCAKTIMI I VLERËS PËR ARKËTIM TË TAKSËS neni 18 përcakton se:

(1) Taksat paguhen sipas vlerës së kërkesave, përkatësisht lëndës së kontestit, kur ajo mund të përcaktohet, përkatësisht sipas vlerës së përcaktuar me këtë ligj.

(2) Për përcaktimin e vlerës së kërkesës, gjegjësisht lëndës së kontestit, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë civile për përcaktimin e vlerës së kontestit në fjalë për shkak të përcaktimit të kompetencës reale, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Vlera e kërkesës, përkatësisht lëndës së kontestit për shkak të arkëtimit të taksës (në tekstin e mëtejme: baza e taksës), përcaktohet sipas vlerës së kërkesës, përkatësisht lëndës së kontestit në kohën e paraqitjes së parashtresës, përkatësisht ndërmarrjes së veprimit.

Në nenin 25 është përcaktuar që (1) Nëse gjykata konstaton, në bazë të kontrolleve të nevojshme të kryera paraprakisht, se vlerën e kontestit për përcaktimin e bazës së taksës pala e ka përcaktuar shumë lartë ose shumë të ulët, gjykata më së voni deri në caktimin seancës përgatitore do të përcaktojë shpejt ose në mënyrë adekuate vlerën e kontestit.

Në vendimin e cekur, vlerën e këtij kontesti pronësie paditësi e ka përcaktuar në shumë prej 40,000 denarë.

Kjo çështje ligjore është shumë e rëndësishme, sepse gjykatat tona kanë pikëpamje diametralisht të kundërta për këtë çështje. Për shkak të interpretimit të dispozitave të LPK-së dhe dispozitave të Ligjit për taksat gjyqësore dhe pikëpamjeve të tilla të pabarabarta, vijmë në situata kur për një kontest për përcaktimin e së drejtës së pronësisë (kontest pronësor) Gjykata Themelore në Krushevë e udhëheq procedurën me një vlerë kontesti prej 40.000,00 denarë, ndërsa një gjykatë tjetër për të njëjtën procedurë e përcakton vlerën e kontestit në 10 milionë denarë.

Për shkak të kësaj, Gjykata Supreme e RMV-së, Seksioni për vepra civile në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, duke diskutuar për çështjet ligjore me interes për zbatimin e vetëm të së drejtës dhe barazimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/05, nr. 110/08, nr. 83/09, nr. 116/10), në një seancë të mbajtur më 23.02.2015, ka miratuar disa mendime juridike, mes të cilave edhe atë që gjykata mund të përcaktojë sipas detyrës zyrtare vlerën e lëndës së kontestit e cila është e meritore për përcaktimin e përbërjes së gjykatës, të drejtës për të deklaruar revizion dhe në raste të tjera të parashikuara me Ligjin për procedurë kontestimore, më së voni deri në caktimin e seancës përgatitore dhe se në kontestet në lidhje me kërkesat jomonetare, vlerë meritore është ajo të cilën paditësi e ka caktuar në padinë dhe në shumën në të cilën është paguar taksa

gjyqësore, nëse përcaktimi i vlerës së kontestit nuk është rregulluar në mënyrë tjetër me Ligjin për procedurë kontestimore. Pikërisht për shkak të kësaj çështjeje juridike për zbatimin e vetëm të të drejtës dhe barazimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e Ligjit për procedurë kontestimore Gjykata Supreme e RMV-së ka miratuar këto mendime juridike, që të mos ketë mosmarrëveshje në zbatimin e këtyre dispozitave. Nga ana tjetër, mosreagimi i tillë nga gjykata e shkallës së parë ndaj vlerës së ulët të përcaktuar të këtij kontesti është në prag të kundërshtimit me nenin 3 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore, përkatësisht gjykata ka lejuar që në dëm të buxhetit të RMV-së palët të disponojnë në mënyrë të paligjshme, jo me kërkesën e tyre, por me shumën e taksave të paguara gjyqësore. Mes tjerash dhe për shkak të kësaj gjykata, si "mjeshtër i kontestit", duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare për zbatimin e vetëm të ligjeve dhe barazimin e vendimeve gjyqësore edhe për këtë çështje. Për shkak të këtyre fakteve, ky gjykim për këtë çështje, përkatësisht pas aplikimit të mendimit juridik parimore ka marrë vlerësim kuantitativ prej 0.

Në një aktgjykim të miratuar në vitin 2019 në Gjykatën Themelore në Manastir, thirrja në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së nr. 94 /2019 nga 12 maj 2020, botuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr.136 nga 27 maj 2010 me të cilin u shfuqizua neni 18 paragrafi 2 i Ligjit për përmbarrim, sipas të cilit përmbarruesit llogarisin kamatën për shpenzimet e caktuara në procedurën gjyqësore të përfshirë në dokumentin përmbarrues - aktgjykim, llogaritur nga miratimi i dokumentit përmbarrues me sqarim se përmbarruesit nuk mund të llogarisin kamatën për shpenzimet nëse nuk është e cekur në mënyrë eksplicite në dokumentin ekzekutiv. Kjo thirrje në këtë vendim, si reper, nuk i referohet çështjes kryesore që është slëndë e kontestit, por është një shembull pozitiv nga gjykata e shkallës së parë për vëmendjen ndaj praktikës gjyqësore pozitive dhe vendimeve në të cilat mund të thirret për zbatimin e vetëm të të drejtës.

Për ato arsye, paditësi me kërkesën për kompensim të shpenzimeve ka theksuar edhe kërkesë për kamatën. Duke marrë parasysh që kërkesa për kompensimin e shpenzimeve është kërkesë monetare, gjykata ka konsideruar se paditësi ka të drejtë në të kamatës ligjore në përputhje me nenin 266 të LMO nëse ekziston vonesë në pagesën. Për të njëjtat arsye, gjykata e ka detyruar të paditurin që t'i paguajë paditësit shpenzimet e procedurës në shumën totale prej 64,926.00 denarë, brenda 8 ditëve pas marrjes së aktgjykimit, dhe nëse nuk e bën këtë, pas këtij afati ai është i detyruar të paguajë kamatvonesë në shumën e normës referuese të kamatës të Bankës Popullore të RMV-së që për çdo gjysmë viti ka vlejtur në ditën e fundit të gjysmës së vitit që i ka paraprirë gjysmë vjetorit aktual, zmadhuar për me 8 pikë përqindje të kësaj shume deri në pagesën përfundimtare.

Aktgjykimi vijues i analizës në aspekt të vendimeve gjyqësore është aktgjykimi nga viti 2020 i miratuar nga ana e Gjykatës themelore Ohër dhe që e trajton çështjen e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial për sëmundje të pësuar fizike, frikë e pësuar, si dhe në emër të sëmundjes shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar

jetësor të shkaktuar nga kafshimi i qenit për të cilin Gjykata Supreme e RMV-së më datë 04.03.2016 ka miratuar mendim juridik parimor për këtë çështje, nëse te gjykatatat paraqitet dilemë në aspekt të legjitimacionit pasiv te i padituri.

Për shkak se në praktikë u paraqitën dilema, në lidhje me atë se kush është legjitimuar të ketë legjitimacion pasiv në konteste të tilla, Gjykata Supreme e RMV-së ka miratuar këtë mendim juridik parimor, por kjo gjykatë gjatë miratimit të vendimit, aspak nuk thirret, me siguri sepse as i padituri nuk ka kundërshtuar në këtë rrethinë.

Më tutje, edhe një vendim ku është e paqartë se si është caktuar vlera e kontestit kur bëhet fjalë për kontest pronësor, e për këtë çështje Gjykata Supreme e RMV-së, Seksioni për vepra civile në Gjykatën Supreme të RMV-së, duke diskutuar për çështjet juridike interes për zbatimin e vetëm të së drejtës dhe barazimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/05, nr. 110/08, nr. 83/09, nr. 116/10), në seancën e mbajtur më 23.02.2015, ka miratuar disa mendime juridike, mes të cilave edhe atë që gjykata mund të përcaktojë sipas detyrës zyrtare vlerën e lëndës së kontestit e cila është e meritore për përcaktimin e përbërjes së gjykatës, të drejtës për të deklaruar revizion dhe në raste të tjera të parashikuara me Ligjin për procedurë kontestimore. Pikërisht për shkak të kësaj çështjeje juridike për zbatimin e vetëm të të drejtës dhe barazimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e Ligjit për procedurë kontestimore Gjykata Supreme e RMV-së ka miratuar këto mendime juridike. Nëse shqyrtohet aktgjykimi mund të shihet se bëhet fjalë për përcaktimin e të drejtës së pronësisë të tokës së ndërtuar ndërtimore, tokë nën ndërtesën, për objekt që gjendet në atë tokë, që do të thotë se në këtë procedurë lëndë e kontestit janë disa patundshmëri për të cilat asesi nuk mund të pajtohem se vlera e tyre është 200.000 denarë sa ka cekur paditësi në padinë.

Këtu qëndrojnë vërejtjet e njëjta nga lart, se është caktuar shumë ulët vlera e këtij kontesti, e ende më shumë që në pajtim me qëndrimin e dytë parimor i cekur më lart në kontestet që kanë të bëjnë me kërkesat jomonetare, vlera meritore është ajo kur paditësi e ka caktuar në padinë dhe në cilën shumë është paguar taksa gjyqësore, e nëse përcaktimi i vlerës së kontestit nuk është rregulluar në mënyrë tjetër me Ligjin për procedurë kontestimore. Nëse në këtë rast është e qartë, e është e padiskutueshme se me LPK në mënyrë tjetër është rregulluar caktimi i vlerës së kontestit, e mbi të gjitha LPK ka dispozita që përcaktojnë se nëse ka më shumë kërkesa padie, vlera e lëndës së kontestit caktohet si përmbledhje e vlerave të çdo kërkesë në veçanti. Prandaj, ky vendim gjyqësor nuk është harmonizuar as me mendimin juridik parimor të GJSRMV-së, as me LPK.

Në një vendim të miratuar në vitin 2020 të Gjykatës themelore Strugë është karakteristike ajo që për këtë çështje juridike GJSRMV-së ka miratuar konkluzion nga 11.09.2015, ku pas kontrollit të kryer të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë Rev2 nr. 69/2014 nga 04.02.2015 dhe Rev2 nr.484/2014 nga 19.02.2015, është konstatuar

shmangie nga praktika gjyqësore në vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë Rev2. nr.484/14. Në këtë aktgjykim bëhet fjalë pikërisht për problem të tillë juridik. Gjegjësisht, këtu sugjerohet në dallimin në zbatimin e nenit 203 të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera reale në praktikën gjyqësore.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë me aktgjykimin Rev2 nr. 484/2014 nga 19.02.2015 miratoi revizionin e paditësit dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Gostivar, kështu që ankesa e të paditurit u refuzua si e pabazuar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e miratuar është vërtetuar. Sipas arsytimit të aktgjykimit në fjalë, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, gjatë zbatimit të së drejtës materiale, i referohet dispozitës së nenit 203 paragrafi 1 të Ligjit për pronën dhe të drejtat e tjera reale, sipas të cilit pronari i sendit të shërbyer ka të drejtë në kompensim për servitutit e vendosur. Gjithashtu, në aktgjykimin e Gjykatës Supreme thotë se "... në rastin konkret paditësi si pronar i sendit të shërbyer kërkon pagesën e kompensimit për të drejtën e përcaktuar vendosur të servitutit të pasurisë së patundshme, duke pasur parasysh se e drejta e servitutit është një e drejtë absolute sendore e cila nuk parashkruhet, është i drejtë konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë se nuk ka parashkrim të kërkesës së paditësit." Megjithatë, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë me Aktgjykimin Rev2 Nr. 69/2014 të datës 04.02.2015, revizionin e paditësit e ka hedhur poshtë si të pabazuar. Gjithashtu, në aktgjykimin e Gjykatës Supreme ceket se "...kërkesa e paditësit është monetare, përkatësisht kompensim për servitutit e vendosur. Me asnjërin nen tjetër të Ligjit për pronësi dhe të drejtat e tjera reale nuk është rregulluar se në cilin afat parashkruhet kjo e drejtë, kështu, dhe në këtë rast, sipas Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, dispozitat e përgjithshme për parashkrim, të parapara me Ligjin për marrëdhënie obligative... "Së këndejmi, me zbatimin e dispozitës nga neni 360 të Ligjit për marrëdhënie obligative, Gjykata Supreme arrin në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë pranuar në mënyrë të drejtë se kërkesa e paditësit është parashkruar sepse padia është parashtruar pas mbarimit të afatit të përgjithshëm prej 5 vitesh, meqë paditësi e ka fituar pronën me trashëgim nga babai i tij me servitut tashmë të vendosur, nga momenti kur ka realizuar të drejtën e shfrytëzuesit (1983), deri në ngritjen e padisë (23.05.2011) ka kaluar një periudhë prej më shumë se 30 vitesh. Në praktikën aktuale gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë në një situatë të ngjashme faktike dhe juridike, shprehet pikëpamja se kërkesa për kompensim për servitutit teknik komunal ose industrial industrial është një kërkesë monetare, e cila sipas dispozitave të përgjithshme të Ligji për marrëdhënie obligative parashkruhet në afat prej 5 vitesh (aktgjykimi i GJSRM Rev. nr. 489/2009 nga 02.07.2009). Duke pasur parasysh këtë, kjo gjykatë gjatë miratimit të këtij vendimi do të kishte edhe një argument më shumë gjatë refuzimit të kërkesës së paditësit, sepse bëhet fjalë për një situatë pothuajse identike juridike.

Sic mund të vërehet, nga vendimet e siguruara për këtë rajon të apelit edhe nga shkalla e ulët e barazimit që rezultoi nga vlerësimi kuantitativ i secilit vendim individual, mund të konkludohet se në këtë rajon të apelit bëhen përpjekje për fillime më serioze për aplikim

edhe të praktikës gjyqësore si burim i të drejtës, me vërejtje që ky trend të mbështetet nga palët kompetente të së drejtës, nga gjykatat më të larta dhe vendimet që përmbajnë thirrje në çdo praktikë adekuate gjyqësore të vlerësohen si vendime me kualitet më të lartë.

2.2.2 Barazimi i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Gostivar

Me analizë të vendimeve të miratuara për këtë rajon të apelit sipas treguesve kuantitativë, në aspekt të barazimit të tyre në pajtim me metodologjinë janë fituar rezultatet e mëposhtme: 0,0, 0, 0, 0, 0, 0, 0, 0, 0 dhe 0;

Treguesit e tillë të vendimeve të analizuara gjyqësore sugjerojnë se aktgjykimet e miratuara në rajonin e Gjykatës së Apelit në Gostivar aspak nuk janë barazuar me praktikën gjyqësore, përkatësisht për çështjet juridike për të cilat ekziston praktikë gjyqësore nuk ka thirrje në të njëjtën.

Shembull i tillë i pabarazisë së praktikës gjyqësore është vendimi i miratuar i Gjykatës së Apelit në Gostivar të i cili lëndë e kërkesës s[padisë është kompensimi në emër të dëmit jomaterial dhe atë për dhimbje fizike, frikë, dhimbje mendore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor me kamatëvonesë e llogaritur mbi shumën e caktuar totale në përputhje me rregullat pozitive, si dhe për dëmin material me kamatë të llogaritur nga dita e ngritjes së padisë, dhe për shumën totale të dëmit jomaterial nga dita e aktgjykimit. Për këtë çështje juridike, Gjykata Supreme e RMV -së ka miratuar mendimin juridik parimor nga 04.03.2016 i cili është cekur dhe komentuar më lart në analizën e vendimeve të tjera gjyqësore, ndërsa thirrja në të njëjtën nga gjykata e shkallës së parë do të nënkuptonte barazim dhe zbatim më të madh të praktikës gjyqësore si burim i së drejtës.

Gjatë analizës nga aspekti i barazimit të vendimit të miratuar në vitin 2018 nga Gjykata e Apelit Gostivar në vitin 2018, lëndë kontestit të të cilit është kompensimi i tokës së shpronësuar, për të cilën çështje ligjore është miratuar mendim juridik nga Seksioni për vepra civile në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, duke diskutuar për çështjet juridike me interes për zbatimin e vetëm të së drejtës dhe barazimit të praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 26.02.2016, sipas së cilës kompensimi për pronën e patundshme të shpronësuar në procedurën para gjykatës përcaktohet nga vlera e tregut sipas llojit dhe karakterit të pasurisë së patundshme në kohën e shpronësimit, bazuar në të dhënat nga Kadastrin e Patundshmërive, pavarësisht nga nevojat dhe dedikime për të cilat shpronësohet ajo patundshmëri. Gjatë miratimit të këtij vendimi, gjykata ka respektuar plotësisht të gjitha rregullat dhe aktet normative të ligjit për procedurën jashtëkontestimore, ligjit për shpronësimin dhe vendimi i miratuar është i dejtë dhe i ligjshëm, por duke pasur parasysh atë që ky mendim juridik është më me datë më të re dhe mund të kontribuojë dukshëm në barazimin e zbatimit të ligjeve.

Sipas vendimit të së njëjtës gjykatë nga viti 2020 të miratuar me rastin e të paditurit të vetëqeverisjes lokale lëndë e kontestit është kompensimi i dëmit të shkaktuar nga qentë endacakë, për të cilin për shkak të barazimit të praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 04.03.2016 GJSRMV-së ka miratuar mendim juridik parimor.

Edhe në këtë rast, thirrja në këtë reper do të kontribuojë në barazimin e vendimeve të miratuara për këtë çështje.

Gjendja është e ngjashme edhe te lënda tjetër për analizë në aspekt të barazimit të vendimeve të miratuara në vitin 2018, ku bëhet fjalë për një gjendje pothuajse identike, përkatësisht një çështje juridike ku gjykata gjithashtu nuk e ka përdorur në argumentimin e saj mendimin juridik të GJSRMV-së

Gjatë analizës së barazimit me praktikën gjyqësore të një vendimi gjyqësor të Gjykatës Themelore Gostivar të miratuar gjatë vitit 2017, mund të konstatohet se kjo procedurë ka përfunduar me aktvendim me të cilin padia e ngritur e paditësit hidhet poshtë si e pa rregullt. Gjykata gjatë shqyrtimit të mëparshëm të padisë në pajim me nenin 266 të LPK, nga inspektimi i padisë dhe dëshmisë së bashkëngjitur, konstatoi se nuk përmban gjithçka që është e nevojshme që gjykata të veprojë mbi të, padisë nuk i ka bashkëngjitur dëshmi të identifikimit personal të paditësit, fotokopje të letërnjoftimit të vlefshme të paditësit, dhe nëse i ka bashkëngjitur fotokopje të letërnjoftimit të pavlefshëm të paditësit, me afat vlefshmërie deri më 12.01.2006. Duke pasur parasysh atë që padia nuk përmban gjithçka që është e nevojshme në përputhje me nenin 98 paragrafi 3 të LPK, dhe në përputhje me nenin 101 paragrafi 1 të LPK parashtresat e paraqitura nga i autorizuar, e që janë të pakuptueshme ose nuk përmbajnë të dhëna nga neni 98 paragrafët (3), (4), (5) dhe (8) të këtij ligji ose nuk janë parashtruar në numër të mjaftueshëm kopjesh kur dorëzohen në formë të shkruar, gjykata do t'i refuzojë ato.

Në këtë kuptim është edhe sentenca e miratuar nga Gjykata Supreme e RMV-së, vendim i rëndësishëm i VSRM Rev3 nr. 20/2014. ku kjo gjykatë në përputhje me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore konsideron se parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe duhet të përmbajnë gjithçka që është e nevojshme që të mund të veprojë mbi to. Në veçanti, ato duhet të përmbajnë: shënimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin të mbështetur me dëshmi për identifikim personal, vendbanim, përkatësisht vendqëndrim të palëve, përkatësisht firmës dhe selisë së personit juridik të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë ose ndonjë tjetër regjistër të mbështetur me dëshmitë nga regjistri përkatës, përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe të autorizuarit, nëse i kanë, lëndën e kontestit, vlerën e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe nënshkrimin e parashtruesit, përkatësisht nënshkrim elektronik, email adresa dhe telefoni i kontaktit.

Në përputhje me nenin 101 paragrafi 1 të ligjit të njëjtë parashtresat e paraqitura nga i autorizuar, e që janë të pakuptueshme ose nuk përmbajnë të dhëna nga neni 98 paragrafët (3), (4), (5) dhe (8) të këtij ligji ose nuk janë parashtruar në numër të mjaftueshëm kopjesh kur dorëzohen në formë të shkruar, gjykata do t'i refuzojë ato.

Duke pasur parasysh dispozitat ligjore të cituara, si dhe faktin që padia në fjalë është ngritur nga paditësi përmes një avokati të autorizuar dhe nuk përmban të dhëna të shkruara për firmën dhe selinë e personit juridik të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, të mbështetur me dëshmi nga regjistri përkatës, del se gjykatat më të ulëta kanë konkluduar në mënyrë të drejtë se padia nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të parashikuara në nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore, me ç'rast të njëjtën e kanë refuzuar atë, në përputhje me nenin 101 paragrafi 1 i ligjit të njëjtë.

Ky dënim vlen për personat juridikë, por të njëjtat dispozita zbatohen kur bëhet fjalë për personat fizikë që janë paditës në kontest, ndërsa padinë e parashtrojnë përmes avokatit të autorizuar.

Të gjitha këto vërejtje dhe komente kanë të bëjnë edhe me vendimin e gjykatës së njëjtë në këtë analizë e cila është miratuar në vitin 2017, sepse bëhet fjalë për gjendjen krejtësisht identike juridike, përkatësisht në pajtim me Ligjin për procedurë kontestimore, parashtresat e paraqitura nga i autorizuari, e që janë të pakuptueshme ose nuk përmbajnë të dhënat nga neni 98 paragrafët (3), (4), (5) dhe (8) të këtij ligji ose nuk dorëzohen në numër të mjaftueshëm kopjesh kur ato dorëzohen me shkrim, gjykata do t'i refuzojë ato. Në praktikë, gjykatat shpesh kanë pasur zakon të kapërcejnë fazën para gjyqit, e cila është veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e duhur të procedurave gjyqësore. Gjegjësisht, nëse gjykata e ka kapëryer këtë fazë, zakonisht caktohet një seancë përgatitore ose një seancë për diskutim kryesor, dhe shpesh mangësitë e tilla formale për të cilat i padituri do të kundërshtonte i refuzon si të pabaza, kështu që kur i padituri do të duhet tanimë të inkuadrohet edhe në diskutim material për padinë, pastaj është vonë më për kundërshtime të tilla. E njëjta gjë ndodh edhe me përcaktimin e duhur të vlerës së kontestit, për të cilën çështje ka vërejtje për disa nga vendimet e analizuara më sipër, kështu që për shkak të këtyre dhe çështjeve të ngjashme faza e shqyrtimit paraprak të padisë është veçanërisht e rëndësishme.

Gjatë miratimit të vendimit të Gjykatës Themelore Gostivar nga viti 2019, lëndë e kontestit është përcaktimi i së drejtës së pronësisë, dhe nëse krahasojmë me vendimet e analizuara më sipër në lidhje me këtë çështje juridike, mund të shohim një dallim dhe shmangje në përcaktimin e vlerës së kontestit. Për këtë çështje, Gjykata Supreme ka miratuar mendime juridike nga 23.02.2015, me të cilat për situata të ndryshme ka miratuar pikëpamjet e saj mbi mënyrën e përcaktimit të vlerës së kontestit. Në parim, nuk është e diskutueshme që ekziston njohje nga të paditurit, se bëhet fjalë për një marrëveshje të realizuar plotësisht në përputhje me nenin 65 të LMO, por për zbatimin e vetëm të së drejtës në të gjithë territorin e RMV-së, do të ishte e drejtë kur kjo gjykatë, gjatë shqyrtimit të mëparshëm të padisë, ndër veprimet e tjera për shqyrtim paraprak, do të kishte përcaktuar në mënyrë të dretë vlerën e këtij kontesti.

Një vendim i marrë gjatë vitit 2019 është një aktvendim i Gjykatës Themelore Gostivar me të cilin padia e paditësit refuzohet si e pa rregullt sepse gjykata në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë, ka konstatuar se padia e paditësit e paraqitur përmes të autorizuarit është e parregullt, me çrast në përbërjen e padisë, nuk është shënuar vendbanimi i paditësit dhe numri i amzës së paditësit nuk ka qenë i mbështetur me dëshmi të identifikimit personal, nuk është dorëzuar asnjë kopje e letërnjoftimit ose pasaportesë së paditësit. Në përbërjen e padisë, selia e të paditurit të parë O.G në bulevardin B.GJ. numri... i përfaqësuar nga personi i autorizuar Kryetari i komunës A. T. nga G dhe J.p. K. C.O.G., nuk është mbështetur me dëshmi, nuk është dorëzuar bilanci i gjendjes në regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë ose regjistër tjetër i mbështetur me dëshmi nga regjistri përkatës si person juridik. Për të paditurin e dytë J. p K.C.O.G. nuk ka qenë e shënuar selia, nuk ka qenë i shënuar numri unik i amzës i subjektit në regjistrin NUAS për personat juridikë, nuk është paraqitur dëshmi bilanci i gjendjes të regjistruar në regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë ose regjistër tjetër të mbështetur me dëshmi nga regjistri përkatës si person juridik. Në dokumentet e lëndës, dëshmitë e bashkangjitura ndaj padisë nuk kanë qenë të bashkangjitura në numër të mjaftueshëm kopjesh. E gjithë kjo është në përputhje me dispozitat e LPK por duket se praktika e tillë filloi të zbatohet pasi Gjykata Supreme e RMV -së ka miratuar mendimin juridik.

Analiza e një vendimi të Gjykatës Themelore Kërçovë nga viti 2020 i cili vendos për padinë e punëtorit për pagesën e regresit pushim vjetor i referohet çështjes juridike për të cilën Seksioni për vepra civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, duke diskutuar për çështjen juridike të për të drejtën e kompensimit për ushqim dhe për regres pushim vjetor pas hyrjes në fuqi të

Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/05), në seancën e mbajtur më 25.05.2010, e ka miratuar konkluzionin se "Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 62/05), nuk ka bazë

për pagesën e regresit për pushim vjetor, nëse nuk është paraparë me marrëveshje kolektive. Me konkluzionin e tillë shumë të shkurtër dhe të qartë, përkatësisht duke u thirrur gjykata në këtë reper dhe duke përcaktuar që i padituri nuk ka nënshkruar një marrëveshje kolektive individuale në nivelin e punëdhënësit me themeluesin - Komuna M. Brod dhe sindikatën përfaqësuese të punëdhënësit, do të ishte shumë më i thjeshtë dhe më i lehtë arsytimi i vendimit të tillë, por edhe aktgjykimi në fjalë do të ishte shumë më i lehtë për t'u shqyrtuar në aspektin e shkëlqeve thelbësore të nenit 343 paragrafi 2, pika. 14 e LPK -së.

Analiza e vendimit tjetër të Gjykatës Themelore Kërçovë të miratuar gjatë vitit 2020 është identike me analizat e bëra më lart të vendimeve në lidhje me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenit për shkak të barazimit të praktikës gjyqësore, në seancë të mbajtur më 04.03.2016 GJSRMV ka miratuar mendim juridik parimor të cilin gjykata nuk e ka përdorur si pikë referimi gjatë miratimit të vendimit në fjalë. Në këtë kuptim,

është miratuar edhe vendimi me shifrën 20G060 të gjykatës së njëjtë, këtu në mënyrë solidare janë paditur edhe komuna edhe ndërmarrja publike që është përgjegjëse për popullsinë dhe kujdesin për qentë endacakë por megjithatë gjykata nuk e ka zbatuar këtë mendim juridik parimor në aspektin e barazimit të vendimeve gjyqësore.

Karakteristikë e këtij rajoni të apelit është se nuk ka aspak thirrje në praktikën gjyqësore. Në hyrjen e kësaj analize është konstatuar se në procesin e mbledhjes së vendimeve nuk kishte kurrfarë bashkëpunimi nga autoritetet kompetente dhe këto vendime u janë mbledhur nga portali GJSRMV-së, kështu që mbetet rezerva që në praktikë dhe në terren situata nuk është pikërisht siç del nga kjo analizë, por në çdo rast është e nevojshme të punohet në këtë problematikë në këtë rajon të apelit.

2.2.3 Barazimi i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Shkup

Duke analizuar vendimet e miratuara për këtë rajon të apelit sipas treguesve kuantitativë, në aspekt të barazimit të tyre në pajtim me metodologjinë janë fituar rezultatet e mëposhtme: 0, 0, 0, 6, 0, 0, 0, 6, 0, 7.5, 0, 7.5, 0, 7.5, 7.5, 4.6, 0, 0, 0 dhe 7.5;

Duke analizuar këto të dhëna kuantitative, mund të fitohet rezultat i barazimit të vendimeve nga rajoni i apelit me indeks të barazimit prej **2.8**.

Gjatë miratimit të vendimit të miratuar gjatë vitit 2017 nga Gjykata e Apelit në Shkup, nuk ka thirrje në mendimin juridik të GJSRMV-së nga 28.10.2013, ku është përcaktuar qartë, si llogaritet kompensimi për marrjen e paautorizuar të energjisë elektrike, siç pohon i padituri nga njehsori i shkyçur dhe joaktiv. Nëse njehsori ka qenë vërtetë i shkyçur dhe joaktiv, do të thotë që i padituri e ka manipuluar atë, dhe nëse e ka manipuluar atë në atë rast, duhet të zbatohet mendimi juridik parimor GJSRMV-së. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi në rastin konkret, përkatësisht paditësi e ka shkyçur pasi ka konstatuar se në njehsorin e çlajamëruar-shkyçur nga i padituri është regjistruar konsum i energjisë elektrike që s'mund të ndodhë nëse është shkyçur, përkatësisht joaktiv, pa manipulim të caktuar nga i padituri, kështu që duke pasur parasysh se i padituri ka manipuluar me njehsorin dhe vetë kërkesa e vendosur e padisë në rastin konkret është është shumë e ulët nga ana e të paditurit.

Me analizën e aktgjykimit nga sfera e të drejtës së punës të cilin e ka miratuar Gjykata e Apelit Shkup tregohet se disa fakte janë të rëndësishme për miratimin e vendimit të tillë në përputhje me ankesën e pranuar të paditësit. Së pari, në cilën datë është parashtruar padia, së dyti, a ndikon parashtrimi e padisë në gjykatë jokompetent vendor mbi parashkrimin dhe së treti, çfarë kërkesë është lëndë e këtij kontesti? A bëhet fjalë për shkelje të të drejtave të marrëdhënies së punës që mund të paraqiten në forma të ndryshme: mospagimi i rogës ose shkurtimi i saj; punë jashtë orarit; shkurtimi i pushimit vjetor; siste-

matizimi në vend tjetër të punës; pezullim ilegal; ndërprerja e paligjshme e marrëdhënies së punës etj. Afati i parashkrimit të kërkesave monetare të punonjësit të cilat ai i thekson me padi në gjykatë kundër punëdhënësit, për shkak të shkeljes së të drejtave të punës dhe për shkak të shkeljes në punë, vlerësohet sipas afateve të veçanta për parashkrim të kërkesave për kompensimin e dëmit të caktuara në Ligjin për marrëdhënie obligative, është esenca e këtij mendimi juridik të Gjykatës Supreme. Sapo ky mendim të thirret në LMO në përputhje me nenin 377, Përfaqësimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent për shkak të përcaktimit, sigurimit ose realizimit të kërkesës. Me këtë, konstatohet se paditësi e ka ngritur padinë një ditë para skadimit të afatit ligjor.

Aktgjykimi i analizuar i Gjykatës së Apelit në Shkup i miratuar gjatë vitit 2018 trajton problemin me shfrytëzuesit e shkyçur të shërbimeve të paditësit shpërndarës i energjisë për ngrohje. Ky aktgjykim u miratua më 26 prill 2018, në një kohë kur ka qenë aktual dhe dy muaj para mendimin të miratuar juridik të Gjykatës Supreme nga 20 shkurtit 2018, me të cilin banorët të cilët s'kanë qenë asnjëherë të kyçur në sistemin e ngrohjes, nuk kanë lidhur kontratë për furnizim me energji për ngrohje dhe nuk kanë instaluar instalim të brendshëm nga furnizuesi i energjisë për ngrohje, nuk kanë statusin e konsumatorëve të shkyçur pasivë dhe me atë nuk duhet të paguajnë kompensim për fuqinë e angazhuar (pjesë fikse e kompensimit të energjisë për ngrohje). Nga provat e nxjerrë të cekura në aktgjykim shihet qartë se e pandehura nuk ka lidhur kontratë për furnizim, nuk ka instalim të brendshëm nga paditësi për përdorimin e energjisë për ngrohje, dhe mbi të gjitha ka dorëzuar edhe konstatim dhe mendim eksperti se nuk ka përcim të energjisë për ngrohje, nga ana tjetër paditësi nuk ka paraqitur provë se ndonjëherë kanë lidhur njëfarë marrëveshje, dhe sipas kësaj për të nuk duhet të vlejnjë rregullat e paditësit.

Aktgjykimi i së njëjtës gjykatë nga viti 2018 është një shembull i shkëlqyer sesi me zbatimin e qëndrimit parimor të Gjykatës Supreme nga 28.10.2013 shumë lehtë zgjidhen dilemat në aspekt të çështjeve juridike që mund të interpretohen ndryshe nga disa rregullore. Mendimi juridik për lartësinë e kompensimit të dëmit në kuptim të nenit 178 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie obligative Gjykata Supreme konsideron se ai duhet të përcaktohet sipas çmimeve në kohën e miratimit të vendimit gjyqësor, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj. Gjatë shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, shuma e kompensimit të cilin shfrytëzuesi është i detyruar ta paguajë, llogaritet në përputhje me Rregullat e rrjetit për shpërndarjen e energjisë elektrike, që janë miratuar në bazë të nenit 77 të Ligjit për Energjistikë, e pas miratimit paraprak nga Komisioni Rregullator i Energjisë i Republikës së Maqedonisë. Në këtë rast, përcaktimi i shumës së kompensimit konsiderohet si rast i nenit 178 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie obligative me ligj është përcaktuar diçka tjetër, kështu që paditësit i takon kompensim për dëmin e zakonshëm dhe kompensim për dobinë e humbur.

Aktgjykimi tjetër i gjykatës së njëjtë të miratuar gjatë vitit 2019 ka të bëjë me problematikën si aktgjykimi më lart dhe e trajton të njëjtin problem të konsumatorëve pasiv të energjisë së ngrohjes, ndërsa ngjashmëritë midis këtyre dy vendimeve janë që asnjëri prej tyre nuk thirret në mendimin juridik parimor nga shkurti 2018 të GJSRMV-së. Në mënyrë të arsyeshme parashtrohet pyetja se si është e mundur për të njëjtin problem juridik, për të njëjtën bazë juridike ku janë paditur persona fizikë të ekzistojnë dy vendime të ndryshme. Dhe pikërisht për shkak të kësaj praktike të pabarabartë në lidhje me këto konteste Gjykata Supreme ka miratuar mendim juridik të lartpërmendur. Të gjitha këto dilema do të zgjidhen me ndjekje të thjeshtë të qëndrimeve, mendimeve juridike parimore dhe konkluzioneve të Gjykatës Supreme, megjithëse nuk janë të detyrueshme, por në atë mënyrë tregohet respekti që gjykatat “më të ulëta” e kanë ndaj GJSRMV-së, e që sipas rendit të gjërave do të duhej ta kishin.

Më tutje në vendimin tjetër të miratuar gjatë vitit 2019, Gjykata e Apelit ka vendosur për ankesat e të paditurit të parë dhe të dytë, të cilët në ankesën thirren në mospasjen e legjitimacionit pasiv, diçka për të cilën Gjykata Supreme në mendimin parimor nga 04.03.2016 e elaboron në mënyrë eksplicite me ç’rast Gjykata konsideron se në raste të tilla “të përgjegjshëm në mënyrë solidare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenit endacak janë komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit dhe Ndërmarrja Komunale Publike ose person tjetër juridik, të cilit me marrëveshje i është besuar mbledhja e qenve endacakë dhe qenve të paregjistruar. Vendimi i Gjykatës së Apelit në çdo rast është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse ka bërë një supsumcion të drejtë dhe ka zbatuar të gjitha rregullat relevante të cilat si rezultat do ta japin aktgjykimin e miratuar dhe mbetet konstatimi se me zbatimin e tillë të të drejtës materiale në disa raste nuk ka nevojë të thirret në mendimin parimor të Gjykatës Supreme, por megjithatë thirrja në mendimin juridik parimor kontribuon në thjeshtimin e çështjeve, sepse në arsyetimin e mendimit juridik të Gjykatës Supreme janë cekur të gjitha rregullat që gjykata i ka zbatuar gjatë miratimit të vendimit, ndërsa nga ana tjetër kontribuon edhe për një përfitim tjetër, dhe kjo është barazimi ose për marrëdhënie të njëjta ose të ngjashme juridike të fitohet rezultati i njëjtë ose gjykimi i ngjashëm. Kuptohet, shuma e kompensimit të dëmit përcaktohet për secilin rast individual në përputhje me vlerësimin e shumës së dëmit të konstatuar nga eksperti dhe mendimi nga fusha profesionale përkatëse. Për shkak të mosthirrjes së gjykatës në mendimin parimor ky vendim për kriterin e barazimit është vlerësuar me zero.

Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkup i miratuar në vitin 2019, me të cilin mënyrë të bazuar është kthyer vendimi i gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe vendimmarrje lidhet me mendimin juridik të Gjykatës Supreme nga 04.03.2016 për të cilin ka një koment më lart ndaj vendimit paraprak, por këtu aktgjykimi i shkallës së parë shfuqizohet për shkak të mungesës së lidhjes shkak-pasojë midis dëmit të shkaktuar dhe kush është përgjegjës për shkaktimin e tij, përkatësisht, nuk është konstatuar në mënyrë të sigurt nëse është qen endacak në cilin rast do të jenë përgjegjës i padituri i parë dhe i dytë ose është qen i pronarit, dhe në këtë rast përgjegjësia e të pandehurve do të përjashtohet.

Një aktgjykim i Gjykatës Themelore Shkup i marrë gjatë vitit 2017 është një shembull i vërtetë i përfitimeve të ndjekjes së mendimeve juridike parimore dhe dhe praktikës tjetër gjyqësore të Gjykatës Supreme nga të gjitha gjykatat, përkatësisht shembull i barazisë, por edhe i përpjekjeve të bëra nga gjykata e shkallës së parë për përmirësimin dhe drejtësi më cilësor. Në këtë kuptim, mendimi juridik është zbatuar në Seksionin për punë civile në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë nga 23.02.2015 sipas të cilit gjykata pas kundërshtimit të paraqitur, vepron dhe diskuton vetëm për faktet në pjesën e përgënjeshtuar pjesë e vendimit, por brenda kërkesës së përfshirë në aktvendimin me të cilin lejohet ekzekutimi, gjykata vendosi në mënyrë meritore në bazë të aktvendimit të miratuar për urdhërpagesën dhe nuk ka pranuar të vendosë për kërkesën precize të padisë në pjesën me të cilën kërkohet që kamatëvonesa ligjore të mos rrjedhë nga 30.06.2010, por nga 30.11.2010, meqë me kërkesën e precizuar të padisë në këtë pjesë kamatëvonesa ligjore kërkohet edhe për periudhë që nuk mbulohet nga urdhërpagesa e lejuar.

Në vazhdim vijon analiza e barazimit të aktgjykimit në të cilin Gjykata themelore Shkup 2 - Shkup e ngarkon të paditurin me pjesë fikse të kompensimit për fuqinë e angazhuar, diçka për të cilën kishte koment edhe më lart, por në një kontekst krejtësisht tjetër. Mendimi juridik parimor i Gjykatës Supreme të RMV-së është miratuar më 20.02.2018, që do të thotë më vonë se miratimi i këtij aktgjykimi dhe nuk ka mund të zbatohet atëherë nga ky shkak praktik që është cekur këtu, por në mënyrë të arsyeshme parashtrohet pyetja nëse gjykata e shkallës së parë ka mund ta zbatojë drejtpërdrejt Konventën evropiane për të drejtat e njeriut.

RMV-ja e ka ratifikuar KVDNJ. Kjo do të thotë se e njëjta duhet të zbatohet drejtpërdrejt, përkatësisht vendi nënshkrues duhet të sigurojë kushte për zbatimin e saj të papenguar.

Gjykata gjatë ndarjes së drejtësisë duhet të ketë ndjenjë për sistemin dhe rendin tonë juridik si një tërësi, përkatësisht parimet themelore t'i kërkojë dhe t'i gjejë ende në aktet më të përgjithshme shtetërore siç është Kushtetuta e RMV-së, dhe nga këtu të vazhdojë drejt rregullave të cilat bëjnë ndarjen në nene dhe përpunimin e këtyre parimeve. Duke filluar me një mendim të tillë vlerat themelore në Kushtetutën janë përcaktuar në nenin 8, e ato janë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe janë përcaktuar me Kushtetutën. Ato liri, e në këtë rast të drejta janë rregulluar në nenin 30 ku garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë. Pronësia krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe komunitetit dhe askujt nuk mund t'i hiqen ose kufizohen pronësia dhe të drejtat që dalin prej saj, përveç kur bëhet fjalë për interes publik të përcaktuar me ligj. Parashtrohet pyetja në mënyrë të arsyeshme për këtë rast si gjykata ka matur sa duhet të kufizohet e drejta e pronësisë së individit për llogari të interesit publik dhe çfarë është interes publik në rastin konkret. Vallë interes publik është leverdia e një subjekti juridik privat dhe nëse ai duhet të vihet para të drejtës së pronësisë private. Këtu është e dukshme se gjykata i ka anashkaluar vlerat themelore të Kushtetutës së RMV-së, Konventa evropiane për të

drejtat e njeriut që do të tregohet më vonë me miratimin e vendimit të KEDNJ Strezovski kundër RMV-së, e në shtojcë të kësaj është edhe MENDIMI JURIDIK I GJSRMV-së nga 07.10.2019 ku GJSRMV-së mban qëndrimin se vendimi gjyqësor nuk mund të bazohet në rregullin i cili nuk ekziston në rendin juridik të RMV-së.

Insistimi i paditësit në këto konteste nuk ndërpritet këtu dhe përmes miratimit të rregullave të reja përpiqen ta anashkalojnë aktgjykimin Strezovski kundër RMV-së, të gjithë qëndrimet dhe mendimet juridike parimore të GJSRMV-së, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, dhe kështu u imponojnë obligime të pamundura “konsumatorëve pasivë” që duhet t'i ndërmarrin që të lirohen nga obligimet ndaj shërbimeve të cilët as që i kanë kërkuar as që kanë lidhur marrëveshje, as që i kanë shfrytëzuar të njëjtat. Për këtë arsye në këtë vendim mungon ndjenja e kësaj gjykate dhe mbrojtja e gëzimit të qetë të të drejtës së pronësisë.

Aktgjykimi i radhës i miratuar gjatë vitit 2018 ka si lënë çështjen e njëjtë dhe me zbatim, përkatësisht thirrje në mendimin juridik parimor të Gjykatës Supreme të RMV-së, kjo gjykatë në mënyrë të drejtë e zgjidh atë krejtësisht ndryshe nga vendimi i mëparshëm i së njëjtës gjykatë, me ç'rast vërtetohet mosmarrëveshja dhe pabarazia e vendimeve për këtë çështje ligjore.

Një nga aktgjykimet e miratuara nga Gjykata Themelore Civile Shkup i miratuar në vitin 2018 i referohet dëmit të shqiptuar jomaterial për kafshimin nga qen endacak për të cilin çështje juridike ka një mendim juridik të Seksionit për vepra civile nga 04.03.2016 të GJSRMV-së. Nga arsyetimi është e dukshme se gjatë procedurës të paditurit debatojnë mes tyre dhe gjykatës mbi legjitimacionit identifikimin pasiv, ndërsa gjykata e shkallës së parë humbi mundësinë për të aplikuar mendimin juridik për rastet e tilla për të sqaruar qëndrimin e tij të drejtë.

Në këtë rast, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm, por për hir të së vërtetës kompensimi i shqiptuar prej 185,000 denarë në krahasim me këtë vendim me të gjithë të tjerët nga rajoni i apelit dhe nga rajonet tjera të apelit është shumë i madh . Në parim, rreth shqiptimit të shumës së kompensimit të dëmit duhet të mbizotërojë bindja e lirë gjyqësore, por megjithatë shuma e shqiptuar duhet të jetë në disa korniza të logjikshme dhe normale.

Aktvendimi në pjesën e shpenzimeve është në kundërshtim me mendimin parimor të GJSRMV-së në pjesën e shpenzimeve për publikimin e aktgjykimit, por ky mendim juridik është miratuar më 07.10.2019 dhe për këtë pjesë nuk duhet të ketë vërejtje, por me aplikim të drejtpërdrejtë të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ nënkuptohet që aktgjykimi duhet të publikohet.

Aktgjykimi tjetër në këtë analizë të miratuar në vitin 2019 trajton të njëjtin problem si ai i mëparshmi, por me atë ndryshim që këtu gjykata ka miratuar aktgjykim plotësisht ligjor,

të drejtë, cilësore dhe të barazuar, që do të thotë aktgjykim sipas të gjitha kriterëve dhe në mënyrë të drejtë është caktuar kompensimi, megjithëse bëhet fjalë për bindje të lirë gjyqësore kur e ka caktuar në 110,000 denarë.

Edhe aktgjykimi i ardhshëm në analizën ka të bëjë me çështjen e njëjtë juridike, ku është evidentuar se aktgjykimi është i drejtë, i ligjshëm, por në pjesën e thirrjes në mendimin juridik parimor të cekur më lartë është e pabarazuar, në veçanti që ky mendim juridik parimor i cekur më lart është i pabarazuar, në veçanti që ky kontest konkret është me tre të paditur, e për një prej të paditurve paditësja gjatë procedurës e ka tërhequr kërkesën e padisë. Pikërisht për këtë shkak, paditësi ka konstatuar me cilën ndërmarrje i padituri i parë ka lidhur marrëveshje për këtë sferë ndaj të paditurit të tretë gjatë procedurës e ka tërhequr kërkesën e padisë. Lidhur me pjesën e shumës së padisë së pranuar, këtu në emër të dëmit jomonetar jepen një shumë totale prej 65,000,000 denarë. Nuk ka nevojë të komentohet nëse bëhet një krahasim me shembujt e mësipërm të aktgjykimeve dhe shumën e kompensimit të shqiptuar të dëmit, megjithëse edhe pse secili rast është më vetë në vete, përkatësisht bëhet fjalë për lloj të ndryshëm të shkeljes, intensitetit i dhimbjes, frikave dhe aktivitetit të zvogëluar të jetës.

Në aktgjykimin tjetër të marrë gjatë vitit 2019, gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kontest për të cilin GJSRMV-së ka marrë mendim parimor juridik nga 04.03.2016, dhe në pjesën e analizës për barazim në tërësi ka miratuar vendim të drejtë, të ligjshëm në të cilën thirret në mendimin juridik të GJSRMV-së, dhe kjo e paraqet në mënyrë koncize, konkrete dhe të qartë në vendimin e vet. Kompensimi i shqiptuar i dëmit është në vlerë prej 75,000 denarë, që korrespondon me kompensimin e shqiptuar nga aktgjykimi i analizuar paraprak.

Gjatë analizës së aktgjykimit vijues në të cilin rol luan të rëndësishëm për barazimin e tij mendimi i GJSRMV-së nga 20.02.2018, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin nga viti 2020 ka sjellë aktgjykim të drejtë, të ligjshëm dhe të barazuar me rregullat e përgjithshme juridike dhe mendimin parimor të Gjykatës Supreme të përmendur më lart mbi të cilin thirret në të.

Karakteristikat e njëjta, dhe akoma më shumë, mund të konkludohet se Gjykata Themelore Shkup ka bërë në aktgjykimin vijues nga viti 2020, dhe përmes shumicës së aktgjykimeve të cekura dhe të analizuara për këtë çështje juridike ne mund të shohim edhe zhvillimin e barazisë, zhvillimin e kuptimeve juridike dhe gjykatësve, veçanërisht edhe nga ky aktgjykim ku gjykata, përveç thirrjes në mendimin juridik parimor, thirret edhe në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë vendim, gjë që paraqet hap përpara në zhvillimin e barazimit të vendimeve dhe duhet të jetë një shembull që duhet ndjekur edhe nga faktorët tjerë.

Në vazhdim edhe një aktgjykim të miratuar në vitin 2020, te i cili lëndë e kontestit është kompensimi i dëmit jomaterial të shkaktuar nga kafshimi i qenit të pastrehë, gjatë shqip-

timit të të cillit gjykata ka caktuar kompensim në vlerë prej 85,000 denarë. Pikërisht gjykata e shkallës pas konstatimeve të palëve dhe gendjes faktike konstaton se si çështje juridike është paraqitur legjitimacioni pasiv i palëve që janë paditur në këtë kontest. Duke pasur parasysh mendimin juridik parimor të GJSRMV-së si dhe epilog më i thjeshtë dhe mjet për arsyetim, kjo gjykatë nuk e ka zbatuar atë gjatë miratimit të këtij vendimi, dhe në atë kuptim nuk është barazuar. Shuma që ai ka dhënë është brenda shumës për të cilën konkludohet se është një nga shumatat më të mëdha të shqiptuara në lëndët e tilla tipike sipas kësaj baze.

Aktgjykimi tjetër i analizuar nga viti 2020 e trajton bazën e njëjtë dhe njëjtë si në aktgjykimin e mëparshëm, gjykata nuk është thirrur në mendimin parimor të Gjykatës Supreme të RMV-së. Kompensimi të cilin e ka shqiptuar në emër të dëmit jomaterial në këtë kontest është 100,000 denarë, prandaj mund të konsiderohet se ky aktgjykim është i pabarabazuar as sipas respektimit të mendimit juridik parimor të GJSRM-së, as sipas shumës së shqiptuar të dëmit jomaterial.

Në lidhje me shembullin e njëjtë të pabarazuar e ndjek edhe aktgjykimi vijues nga viti 2017 ku Gjykata Themelore Shkup, që është veçanërisht interesante, e ngre dhe e analizon çështjen e shkallës së përgjegjesisë së të dyja palëve të paditura në këtë kontest, e sa për informatë kompensimi i shqiptuar është 130,000 .00 denarë me ç'rast bën pjesë në vendime me kompensim të lartë të dëmit në lidhje me të analizuarit paraprak. Duke e pasur parasysh atë që është përmendur, gjykata konsideron se gjatë zgjidhjes së të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe NP H.K.SH ato eventualisht duhet ta sqarojnë çështjen nëse NP K.H. ka vepruar në kundërshtim me Programin dhe marrëveshjen ose nëse Qyteti i Shkupit, nuk i ka kryer plotësisht obligimet e veta që i ka në pajtim me Ligjin dhe që duhet t'i ndërmarrë për shkak të mbrojtjes së qytetarëve nga qentë endacakë, që do të thotë, çështja e përgjegjesisë mund të zgjidhet vetëm ndërmjet qytetit të Shkupit dhe NP K.H. Por ndaj palëve të treta, siç është në këtë rast paditësi dhe Qyteti i Shkupit dhe NP H.K kanë përgjegjësi solidare për të kompensuar dëmin, sepse paditësi ka pësuar dëm për shkak të mosmarrjes së masave nga dy të paditurit. Cili nga të paditurit nuk ka ndërmarrë veprime të tilla dhe çfarë ka humbur është çështje që ata mund ta zgjidhin me njëri -tjetrin sipas marrëveshjes që kanë nënshkruar, por mes tyre, dhe jo ndaj palëve të treta. Sipas mendimit të kësaj gjykate, për dëmin e shkaktuar ndaj palëve të treta në mënyrë të pabazuar negocionojnë të paditurit në legjitimacionet e tyre, me atë që në kontestin eventual reciprok për kërkesë regresive me përgjegjësi solidare për dëmin që do të paguajnë, ata mund ta zgjidhin se në cilën anë është faji, përkatësisht cili prej tyre dhe sa është përgjegjës në kuadër të përgjegjesisë solidare për dëmin e shkaktuar të personit të tretë.

Konstruktive është kjo analizë e kësaj gjykate gjatë miratimit të këtij vendimi rreth legjitimacionit pasiv të të paditurve në këtë kontest sepse në aktgjykimet e analizuar deri tani përsëriten punët e njëjtë rreth legjitimacionit pasiv, rreth shumës së kompensimit të dëmit, rreth kohëzgjatjes së dhimbjeve të pësuar, aktivitetit të zvogëluar jetës, frikës etj.

Në çdo rast, mund të bëhet dallimi midis përgjegjesisë së Qytetit të Shkupit dhe Ndërmarrjes Publike, te Qyteti i Shkupit është objektive, sepse ka angazhuar person të tretë për kryerjen e detyrimeve të caktuara nga fushëveprimi i tyre dhe detyrime të përcaktuara si ligjore, ndërsa te ndërmarrja komunale duhet të jetë më subjektive, përkatësisht për çdo rast konkret duhet të analizohen rrethanat nën të cilat ka ndodhur dëmi, nëse qeni endacak iu është nënshtruar njëfarë trajtimi apo jo, nëse të Ndërmarrja publike i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, sepse përgjegjësia e qytetit të Shkupit buron nga ligji. Kjo ka të bëjë nëse ato ndërmjet tyre pas mbarimit të kontestit të tillë eventualisht e zgjidhin momentin e vëllimit të përgjegjesisë solidarë.

Aktgjykimi i miratuar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore Gjykata Civile Shkup është një shembull ku gjykata përveç zbatimit të duhur të së drejtës materiale në aspektin e barazimit me zbatimin e mendimit juridik parimor të Gjykatës Supreme të RMV-së nga Mbledhja e përgjithshëm e mbajtur më 01.03.2012, ku konsiderohet se marrëveshja për shpërblim për shërbimet e avokatit e lidhur mes avokatit - të autorizuarit dhe palës në pjesën me të cilën përcaktohet përqindja e shpërblimit, dhe do të llogaritet pas plotfuqishmërisë së procedurës, kur gjykata do të miratojë vendim për shumën, është e pavlefshme.

Sidoqoftë, kjo gjykatë ka konsideruar në mënyrë të drejtë se ky mendim juridik, nuk gjen zbatim në rastin konkret, për shkak që në marrëveshjen për urdhëresë të lidhur midis paditësit dhe të paditurit, shuma e shpërblimit është dakorduar në shumë fikse, pavarësisht nga shuma e shqiptuar në mënyrë të plotfuqishme, ndërsa shuma e shpërblimit nuk është dakorduar në përqindje nga shuma e shqiptuar e plotfuqishme.

Përfundimi i përgjithshëm është se në përgjithësi në këtë rajon të apelit, barazimi i vendimeve nuk është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, mund të thuhet se nëse vendimet analizohen në mënyrë kronologjike, përparimi mund të shihet në këtë fushë, që është për t'u përshëndetur. Është evidente se shihet dallimi në kualitetin dhe barazimin e vendimeve gjyqësore, e veçanërisht që nga viti në vit rritet kualiteti, por edhe gjykatat më shumë thirren në mendime dhe qëndrime juridike parimorese të Gjykatës Supreme, si dhe të praktikës gjyqësore evropiane.

2.2.4 Barazimi i vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit Shkup

Me analizë të vendimeve të miratuara në këtë rajon të apelit sipas treguesve kuantitativë, në lidhje me barazimin e tyre në pajtim me metodologjinë janë fituar rezultatet e mëposhtme: 0, 0, 0, 0, 0, 6, 2 dhe 0;

Vlera e indeksit të barazimit të vendimeve nga rajoni i apelit Shtip është 1.

Aktgjykimi i miratuar nga Gjykata e Apelit Shtip gjatë vitit 2017 ka të bëjë me pronën e shpronësuar nga personat fizikë dhe me këtë aktgjykim pranohet ankesa e ish-pronarëve me arsyetim se nuk është bërë vlerësi adekuat i vlerës së pronës së konfiskuar në përputhje me dispozitat ligjore. Në komentin e Mendimit juridik të GJSRMV-së të miratuar më 26.02.2016 ka një pjesë e cila i referohet faktit se vlerësimi i vlerës së tregut të lëndës së vlerësimit, sipas ligjit për vlerësimet, bëhet në mënyrë të përcaktuar me metodologjinë, rregullat dhe standardet e vlerësimit që i përfshijnë Standardet Evropiane të Vlerësimit të Vlerës- TEGOVA dhe Standardet Ndërkombëtare të Vlerësimit të Vlerës- IVSC“, si dhe ligje të tjera që rregullojnë vlerësimin e formave të ndryshme të pronësisë dhe rregullat tjera të miratuara në bazë të tyre. Nuk është plotësisht e qartë nëse vlerësimi bëhet sipas vlerës së tregut të pronës së konfiskuar, karakteri i tokës luan një rol të rëndësishëm në gjithë këtë punë, pra në përcaktimin e vlerës së pronës së shpronësuar. Sidoqoftë, nëse jo në tërësi, atëherë gjykata ka mund të paku në një pjesë të thirret në këtë mendim juridik për shkak të mbështetjes së aktgjykimit të miratuar.

Edhe aktgjykimi tjetër i Gjykatës Themelore në Shtip i miratuar në vitin 2019 ka të bëjë me problemin e njëjtë juridik sesa me përcaktimin e kompensimit në para për patundshmëri të shpronësuar, me faktin që pikërisht tek ky aktgjykim të zbatuar, gjegjësisht thirja në këtë mendim juridik ende është më e nevojshme, sepse si çështje juridike paraqitet karakterin i tokës së konfiskuar për të cilën GJSRMV-së në mendimin juridik parimor nga 26.02.2016 ka marrë udhëzime konkrete si duhet të vepohet në raste të tilla, përkatësisht që për përcaktimin e vlerës së pronës treguesit esencialë që duhet të respektohen janë kultura kadastrale dhe klasa e asaj toke, kështu që në krahasim me patundshmëritë tjera të ngjashme për të bërë vlerësim të përshtatshëm në përputhje me ligjin.

Të njëjtën çështje juridike e trajton gjykata edhe në vendimin e ardhshëm nga viti 2019, ku nuk është pranuar ankesa e propozuesit të shpronësimit me arsyetim adekuat, por përsëri gjykata nuk është thirrur në mendimin juridik parimor të GJSRMV-së, për këtë arsye vendimi sipas këtij kriteri nuk ka aspak atribut kuantitative. Kjo praktikë e Gjykatës së Apelit vazhdon edhe në vitin 2020 me miratimin edhe të një aktgjykimi tjetër me ç’rast mund të thuhet, pra të miratohet konkluzion se në fushën e barazimit praktikisht nuk vërehet përparim në fushën e barazimit.

Analiza vazhdon me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Shtip nga viti 2017, ku lëndë e kontestit është kërkesa për regres për kompensimin e dëmit të cilin kompania e sigurimeve ia ka paguar palës së të dëmtuarit. Sipas mendimit juridik të GJSRMV-së nga 28.04.2014 “Automjeti i pasiguarur me të cilin është shkaktuar aksident në rrugë, vetvetiu nuk përbën bazë për të drejtën e regresit të Shoqërisë së sigurimit, por duhet në anën e drejtuesit të automjetit, përkatësisht pronarit të automjetit, të ekzistojë kontribut për shkaktimin e dëmit, si bazë për pagesën e kërkesës së regresit.” Gjatë dëshmimeve nga të cilat del se pronari i automjetit nuk ka pasur kurrfarë kontributi gjatë shkaktimit të dëmit, kjo gjykatë ndaj tij e ka refuzuar kërkesën e padisë si të pabazë, ndërsa paditësi

e ka ngarkuar me shpenzime të procedurës. Ky gjykim mbi barazinë nuk është vlerësuar fare, sepse në të Gjykata Themelore nuk është thirrur në këtë mendim parimor juridik.

Në aktgjykimin vijues të Gjykatës Themelore Shtip nga viti 2017 thirret në rregullat e Deklaratës universale për të drejtat e njeriut si dhe nga Dispozitat e nenit 2 paragrafi 2 i Ligjit për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje parashikon që kufizimet e lirisë së të shprehurit dhe informimit rregullohen ligjërisht duke vendosur kushte të rrepta për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Neni 10) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila përfshin lirinë e mendimit dhe shprehjes, dhe lirinë për të marrë dhe dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen të Konventës, realizimi i këtyre lirive nuk është absolut sepse ato përfshijnë detyrime dhe përgjegjësi, kështu që në kushte të caktuara ato mund të kufizohen dhe sanksionohen nëse parashikohen me ligj dhe kur në një shoqëri demokratike do të përcaktohet se shfrytëzimi i lirisë së shprehjes cenon reputacionin ose të drejtat e të tjerëve.

Vendimi i Gjykatës Themelore Shtip nga viti 2019 trajton të njëjtin problem si vendimi i mëparshëm, kështu që gjatë miratimit të tij thirret në KEDNJ në kuptimin që “Në përputhje me nenin 3 të Ligjit për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje:” Nëse gjykata me zbatimin e dispozitave të këtij ligji nuk mund të zgjidhë një çështje të caktuar lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë për fyerje ose shpifje, ose konsideron se ekziston vakum ligjor ose konflikt i dispozitave të këtij ligji me Konventën Evropiane për Mbrojtjen

të drejtave themelore të njeriut, mbi parimin e avantazhit të tij mbi të drejtën vendore do t'i zbatojë dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe pikëpamjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të përfshira në aktgjykimet e saj. Në përputhje me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, çdo qytetar ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Këtu i padituri është i lirë nga përgjegjësia civile meqë bën pjesë në kategorinë e cila është e përjashtuar nga përgjegjësia, përkatësisht sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane, e njëkohësisht duke pasur parasysh faktin e konstatuar se i padituri është gazetar me profesion, gjykata konsideron se në lirinë e të shprehurit përkatësisht njoftimi për çështje me interes publik, përkatësisht publikime që kanë të bëjnë me politikanë dhe deklaratat e tyre për çështje më të gjera për të cilat ekziston një interes publik legjitim mund të përdorin fjalë të fuqishme kur raportojnë dhe shprehin pikëpamjet e tyre deri në ekzagjerim dhe madje edhe provokim.

Me aktgjykimin tjetër i miratuar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore Shtip përfundon analiza e barazimit të aktgjyqimeve edhe në këtë rajon të fundit të apelit. Përkatësisht, ky aktgjykim ka të bëjë me posedimin e cenuar nga e paditura ndaj paditësve dhe këtu Gjykata Themelore, mes tjerash, mund të thirret në KEDNJ -së dhe atë në nenin 8, nenin

17 dhe nenin 1 nga protokollin 1, sepse këto vlera garantohen nga rregullat tona pozitive, por edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëse analizojmë vendimet të cilat në këtë rajon të apelit janë barazuar mund të vërehet se ato vendime janë kryesisht të barazuara, të cilat për nga natyra e gjërave, përkatësisht sipas rregullave ligjore të të drejtës sonë pozitive, tregojnë zbatimin KEDNJ, kështu që mbetet përshtypja se në këtë rajon të apelit nëse dispozitat e të drejtës së brendshëm nuk i referohen në mënyrë eksplicite KEDNJ -së, nuk do të kishte fare shkallë të barazimit.

2.3 BARAZIA E VENDIMEVE NË NIVEL KOMBËTAR

Në nivel kombëtar, pas përlogaritjeve dhe krahasimeve, indeksi i barazimit është 1.25. Konkluzioni është se ky është ende një indeks i vogël i barazimit në nivel kombëtar, se gjykatat janë ende në mënyrë të turpshme guxojnë të thirren në praktikën gjyqësore kombëtare, aq më pak në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose në dokument ndërkombëtar ose vendim të rëndësishëm - pikë referimi. Në përgjithësi, praktika gjyqësore në jurisprudencën në gjykatat tona ndryshon nga "kryerja" e praktikës gjyqësore të paraqitur si "dëshmi" dhe vendosja në dëshmitë e paraqitura, e deri në thirrje studjuese, cilësore dhe të përpunuar saktësisht, e cila, për fat të keq, mund të haset shumë pak në këto vendime të analizuara. Faktor kufizues i kësaj analize është se nuk ka pasur bashkëpunim për të siguruar vendime gjyqësore kualitative për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre, por nga ana tjetër me këtë analizë ku një numër vendimesh analizohen rastësisht, është pasqyruar realisht gjendja faktike në terren siç është momentalisht.



KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET

Indeksi i kualitetit të vendimeve gjyqësore në nivel kombëtar është **4.82**.

Nëse e kemi parasysh metodologjinë e këtij hulumtimi, si dhe vendimet e përzgjedhura rastësisht për analizë nga të gjitha rajonet e apelit në RMV, të cilat mund të konsiderohen si një përfaqësues i përshtatshëm i të gjitha vendimeve gjyqësore, është i kënaqshëm rezultati në nivel kombëtar.

Në parim, të gjitha vendimet kanë supsumcion të plotë dhe të drejtë me një postulat të madh dhe përmes deduksionit zbatohen parimet e një postulati të vogël me një përfundim të fituar logjikisht me të gjithë elementët e nevojshëm. Ka kryesisht sqarime koncize dhe të qarta të historikut të çështjes duke iu referuar aktiviteteve të nevojshme dhe të ndërmarra nga gjykata. Mund të shihet se në disa vendime, pak a shumë, që në pjesën e parë bëhet një hyrje në çështjen.

Ekziston një përshkrim i qartë i fakteve dhe rrethanave që sqarojnë thelbin e lëndës, në paragrafë të veçantë duke dhënë një sqarim të fakteve materiale dhe zbatimit të parimeve ligjore.

Analiza tregon se ka vetëm fakte, të cilat janë të rëndësishme për sqarimin e vendimit në një numër të madh vendimesh. Ndërsa, në disa prej tyre ekziston përmendje edhe të fakteve të parëndësishme që ngarkojnë pa nevojë vendimin.

Konstatimi i përgjithshëm të shumica e vendimeve është se normat juridike për secilën çështje janë sqaruar në mënyrë të drejtë me sqarim të të drejtës materiale.

Detektohet se përmes logjikës deduktive janë zbatuar rregulla të përgjithshme në raste konkrete. Në mënyrë të drejtë është përdorur logjika induktive e cila në shumicën e vendimeve mund të zbatohet në një numër të pacaktuar rastesh. Janë cituar në mënyrë të drejtë rregullat relevante në lidhje me secilin kontest konkret.

Përmes një analize të thelluar shihet se faktet konkrete të vendimeve të Gjykatave Themelore në nivel kombëtar korrespondojnë me atë që kërkohet nga e drejta materiale. Në lidhje me të, ato prodhojnë pasojën juridike të përfshirë në aktgjykimin. Dëshmitë e dhënë janë vetëm ato që janë në funksion të këtyre vendimeve.

Analizat treguan se vendimet karakterizohen edhe me vlerësim të drejtë të secilës dëshmi veçmas dhe të gjitha dëshmive si një tërësi dëshmuese.

Në aspekt të kualitetit të dëshmive kryesisht janë autentike, të besueshme dhe konsekuente, dhe faktet jorelevante janë në numër shumë të vogël.

Kryesisht në të gjitha vendimet janë sqaruar argumentet e palës që ka humbur këtë kontest duke krahasuar argumentet e palës që ka fituar kontestin, duke i vendosur ato në korrelacion me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale.

Në vendimet gjyqësore, shpjegimet janë koncize pa detaje të panevojshme. Në shumicën e vendimeve nuk ka kopje të procesverbaleve nga diskutimet. Dëshmitë janë sqaruar plotësisht, jo vetëm të përshkruara nga procesverbalet, ndërsa pohimet e palëve sublimohen dhe rrallë kopjohen nga procesverbali. Në mënyrë të detajuar janë arsyetuar aktvendimet për shpenzimet.

Në përgjithësi, të gjitha aktgjykimet janë të kuptueshme, me paragrafë të shkurtër lidhshmëri të mirë të mendimeve, e secili paragraf trajton një temë, përkatësisht çështje, dhe paragrafët në parim janë koherentë në strukturën e tyre, mbështesin një qëndrim ose problem nga fillimi deri në fund të paragrafit.

Konstatimet tregojnë se aktgjykimet janë me fjalë të sakta gramatikore dhe fjali me gjuhë pothuajse letrare maqedonase, me më pak përzjerje nga dialekti vendor dhe me një numër të vogël gabimesh teknike.

Vlerësohet se në nivel kombëtar, gjatë analizës kualitative të vendimeve gjyqësore është absolutuar çështja, përkatësisht kriteri si për nga forma dhe struktura e tij duhet të duket një vendim gjyqësor dhe ky parametër respektohet përgjithësisht në të gjithë vendin, në të gjitha rajonet e apelit.

Një element i rëndësishëm që duket se gjykatat, e veçanërisht gjykatat themelore në të gjitha rajonet e injorojnë, është fakti se në shumë raste kapërcehet faza e analizës paraprake të padisë. Kjo fazë është shumë e rëndësishme dhe kontribuon që në fillim për të zgjidhur pengesat procedurale dhe për të fituar një mënyrë më ekonomike dhe më të shpejtë të zgjidhjes së kontesteve gjyqësore. Nëse gjykatat e rregullta themelore praktikojnë rregullisht këtë procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë, procedurat do të ishin shumë më ekspeditivë me kritere objektive dhe të bazuara te të gjitha rajonet e apelit. Me këtë, do t'u jepet fund rasteve ku për problemin e njëjtë juridik, përkatësisht lëndën e kontestit në gjykata të ndryshme do të diskutohet sipas vlerave të ndryshme të kontesteve, dhe do të kontribuojë edhe në barazimin dhe praktikën e vetme gjyqësore.

Logjika juridike është gjithashtu një element përbërës shumë i rëndësishëm i një vendimi gjyqësor. Në vetëm disa vendime, nga ato të analizuar, logjika juridike nuk është në një nivel të kënaqshëm.

REKOMANDIMET

Sipas analizës, rekomandohet që në të ardhmen të rritet aktiviteti i seksioneve të praktikës gjyqësore.

Nevojitet një bashkëpunim më i madh në nivel të gjykatës me të gjithë gjykatësit.

Të vendoset bashkëpunim më i madh i këtyre seksioneve në nivelin e apelit, mes tyre, si dhe bashkëpunim të detyrueshëm të këtyre seksioneve midis secilës Gjykatë të Apelit.

Për çështje të caktuara ligjore, për të cilat ka dallime të dukshme, duhet të bëhen harmonizime dhe koordinim reciprok.

Trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve është i nevojshëm për të kontribuar për barazim më të madh.

Është e nevojshme të zbatohet në mënyrë të drejtë faza e shqyrtimit paraprak të padisë në lidhje me mendimet juridike të GJSRMV-së.


Gjykatat duhet ta tejkalojnë gjendjen e mosmarrëveshjes në lidhje me elementët e detyrueshëm të cilat duhet t'i përmbajë padia.

Duhet të vazhdojë trendi i identifikimit të problemeve juridike që kanë gjykatat dhe fushat në të cilat ka një qasje të ndryshme të gjykatave në lidhje me çështje të caktuara juridike.

Përmes takimeve të përbashkëta të Gjykatës Supreme të RMV-së me gjykatat e apelit të merren qëndrime të përbashkëta për çështje të caktuara juridike për barazim më të madh në vendimmarrje.

Ky trend duhet të ndiqet nga secila Gjykatë e Apelit në rajonin e saj të apelit, përkatësisht në gjykatat themelore që të përcjellin konkluzionet dhe pikëpamjet e marra dhe të kujdesen për zbatimin e tyre gjatë miratimit të përditshëm të vendimeve nga ana e tyre.

Për të ndjekur udhëzimet dhe qëndrimet që i marrin gjykatat e apelit në takimet e tyre, konkluzionet e këtyre takimeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.



ANEKSI

SHTOJCA 1-a: FORMULARI PËR ANALIZËN E KUALITETIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

Vendimi gjyqësor nr. _____

Shifra _____

ANALIZA E VENDIMIT GJYQËSOR TË GJYKATËS THEMELORE

Nr. i treguesit	Treguesi	Vlerësimi	Koeficienti	Vlera e indik.	Shënim
1	Struktura e vendimit gjyqësor		1		
2	Sentenca		2		
3	Koherenca		2		
4	Sillozizmi juridik gjatë supsumcionit/logjika juridike		3		
5	Sqarimi i historikut të çështjes		2		
6	Prezantimi i lëndës/ çështjes		2		
7	Prezantimi dhe zbatimi i dispozitave relevante ligjore dhe nënligjore dhe parimeve juridike		2		
8	Gjendja faktike dhe procedura e dëshmisë		1		
9	Shqyrtimi dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta		2		
10	Qartësia dhe konsistenca e arsyetimit		1		
11	Korrekhtësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor		1		

SHTOJCA 1: FORMULARI PËR

Gjithsej: _____ Treg. = _____

Vlerësim/Shënim i përgjithshëm;

SHTOJCA 1-b: FORMULARI PËR ANALIZËN E KUALITETIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

Vendimi gjyqësor nr. _____

Shifra _____

KUALITETI I VENDIMIT GJYQËSOR TË GJYKATËS SË APELIT

Nr. i treguesit	Treguesi	Vlerësimi	Koeficienti	Vlera e indik.	Shënim
4	Sillojzmi juridik gjatë supsumcionit/ logjika juridike		3		
10	Qartësia dhe konsistenca e arsytimit		1		
11	Korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor		1		
12	Udhëzime të qarta për gjykatën themelore në rast të kthimit të vendimit për rishqyrtim		2		
13	Janë cekur qartë shkaqet e shfuqimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.		2		
14	Nëse ka ndryshuar vëllimi ose lartësia e sanksionit, kjo në arsyetimin është cekur qartë pse është bërë ndryshimi, duke theksuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore.		2		
15	U jepet përgjigje ankesave		2		
16	Gjendja faktike nuk transkriptonet nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë		1		

17	Gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit ka të gjitha karakteristikat në konstatimin e gjendjes faktike, analizës së dëshmive, cekjes e të drejtës materiale dhe arsyetimit, si dhe për çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë.		2		
18	Vendimet e gjykatës së apelit me të cilat refuzohet ankesa, kanë arsyetim vetëm për ato ankesa të cilat nuk janë cekur më parë dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë.		2		
19	Gjykata e Apelit i kushton vëmendje afatit përparashkrimin absolut të lëndës kur duhet të vendosë gjykata e shkallës së parë.		2		

Gjithsej: _____

Treg. = _____

Vlerësim/Shënim i përgjithshëm;

SHTOJCA 2: FORMULARI PËR ANALIZËN E BARAZIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

Numri i vendimit gjyqësor-----

Numri i burimit të praktikës gjyqësore/pikë referimi: -----

Shifra _____

Nr. i treguesit	Treguesi	Vlerësimi	Koeficienti	Vlera e indik.	Shënim
1	Lidhur me çështjen juridike që është lëndë e vendimit gjyqësor i cili është duke u analizuar, ka thirrje në praktikën gjyqësore maqedonase - pikë referimi ose praktikën të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut			3/-3 (për të zgjedhur)	ANALIZA E CILËSISË DHE BARAZIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË SFERËN CIVILE-JURIDIKE
2	Logjika juridike		3		
3	Përputhshmëria me praktikën gjyqësore të nenit të ligjit/ aktit nënligjor/ marrëveshjes ndërkombëtare në të cilën thirret në vendimin		2		
4	Thirrja në të a.q lënda udhëheqëse, përkatësisht lënda e cila paraqet lëndë të parë të cilën e ka inicuar Gjykata Supreme për të miratuar mendim ose vendim juridik		2		
5	Për shkelje të njëjtë ose të ngjashme të ligjit ekziston sanksion i ngjashëm ose i njëjtë		2		
6	Lënda e përzgjedhur duhet të jetë e zbatueshme në aspekt adekuat të nenit përkatësisht materies		2		

7	Rëndësia e lëndës që citohet		2		
8	Pjesë të përshtatshme për citim		1		
9	Teknika të përshtatshme për citimin e vendimeve dhe aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut		1		

Gjithsej: _____

Treg. = -----

Vlerësim/Shënim i përgjithshëm;

